

unicef 
for every child

QËNDRO!



SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Manual për parandalimin e
braktisjes së shkollës

Për ofruesit e AFP-së në Shqipëri

Aspektet socio-emocionale

Pjesa II



Mirënjohje

Manuali për parandalimin e braktisjes së shkollës për shkollat e Arsimit Formimit Profesional (*Pjesa e dytë*) u hartua bashkërisht nga Laetitia Antonowicz (Konsulente e UNICEF-it), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Qendrën për Aftësi Konkurruese (CCS), në kuadër të projektit QËNDRO, financuar nga Qeveria Italiane. Ky manual bazohet në përvojën dhe punën e UNICEF-it për parandalimin e braktisjes së shkollës në Evropë dhe Azinë Qendrore që nga viti 2012, si dhe në publikimet e mëparshme të UNICEF ECARO mbi këtë temë. Ai është përshtatur me kujdes për të adresuar nevojat specifike të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri.

Përmes këtij manuali, synohet të ofrohet një udhëzues praktik për shkollat e AFP-së në Shqipëri, duke përfshirë strategji dhe masa konkrete për parandalimin e braktisjes së shkollës.

Ky modul informon si dhe u jep ide praktike stafit arsimor se si të mund të mbështesin nxënësit që mund të jenë duke kaluar tranzicionet arsimore, se si mund të ndërtojnë marrëdhënie pozitive me nxënësit, jep këshilla për aktivitete sociale dhe për mirëqenien e nxënësve, si mund të zhvillojnë aktivitete që ulin ankthin dhe stresin, sugjeron strategji të mësimdhënies me në fokus nxënësit, se si shkolla mund të jetë një hapësirë që mirëpret dhe përfshin prindërit në aktivitete, etj.

Përmbajtja

Parandalimi i braktisjes dhe ndërhyrjet në përgjigjen ndaj saj	4
MJETI 1. Lehtësimi i tranzicioneve arsimore.....	4
MJETI 2. Lidhja me shkollën dhe pjesëmarrja e nxënësve.....	8
MJETI 3. Marrëdhëniet pozitive nxënës-mësues.....	11
MJETI 4. Menaxhimi i sjelljes sfiduese	15
MJETI 5. Mbështetja e bashkëmoshatarëve	21
MJETI 6. Mbështetja e mirëqenies.....	22
Aneks 1. Anketa e kontrollit të mirëqenies	24
MJETI 7. Të nxënës socio-emocional.....	29
MJETI 8. Përballja me ankthin dhe stresin	36
MJETI 9. Parandalimi i diskriminimit dhe bullizmit	36
MJETI 10. Menaxhimi i të mësuarit dhe të mësuarit për të mësuar	39
MJETI 11. Strategji për mësimdhënien dhe të nxënës gjithëpërfshirës.....	42
MJETI 12. Mësimdhënia plotësuese	46
MJETI 13. Zhvillimi i aftësive të punës dhe sipërmarrjes.....	48
MJETI 14. Angazhimi i prindërve.....	50
MJETI 15. Puna me agjencitë dhe komunitetet e tjera.....	56
MJETI 16. Trajtimi i martesës së hershme	59
Detyra 1. Tranzicionet arsimore	61
Detyra 2. Mirëqenia e nxënësit.....	62
Detyra 3. Mbështetja për të mësuarit	63
Detyra 4. Përfshirja e prindërve.....	64
Detyra 5. Puna me shërbimet lokale dhe komunitetet	65
Aneks 2. Burime Shtesë	66
Aneks 3. Bibliografia	67

PARANDALIMI I BRAKTISJES DHE NDËRHJRJET NË PËRGJIGJEN NDAJ SAJ

MJETI 1. LEHTËSIMI I TRANZICIONEVE ARSIMORE

"Tranzicionet në arsim janë kritike në parandalimin e braktisjes së shkollës pasi shumë nxënës e braktisin arsimin mes arsimit bazë dhe të mesmë të lartë ose AFP."

Barrierat për tranzicionin e lehtë në arsim

Kalimi ndërmjet cikleve arsimore duhet të konsiderohet si një proces në kohë dhe jo si një ngjarje e vetme. Si nxënësit, ashtu edhe prindërit mund të kenë shqetësime për kalimin nga shkolla e mesme e ulët në atë të mesme të lartë ose AFP.

	Barrierat
Nxënësit	- Niveli i ulët i informacionit për të bërë një zgjedhje në lidhje me një shkollë ose një drejtim (arsimi i përgjithshëm kundrejt AFP-së, drejtimet e AFP-së, etj.) - Frika në përballimin e kostove që lidhen me arsimin - Ankthi për vendndodhjen/transportin/konviktin - Frika nga bullizmi dhe izolimi - Vetëbesimi i ulët në aftësitë akademike ose sociale - Shqetësimet rreth përshtatjes në drejtimin e zgjedhur arsimor - Vështirësi në përshtatjen me rutinën e re - Vështirësi në përshtatjen me metodat e reja të mësimdhënies - Vështirësi në përshtatje me ngarkesën e shkollës dhe ritmin e studimit - Motivim i ulët për të mësuar pas një ndërprerjeje të gjatë në arsim
Prindërit / familjet	- Moskuptimi i sistemit arsimor/drejtimeve arsimore - Frika në përballimin e kostove që lidhen me arsimin - Shqetësimet lidhur me përshtatshmërinë e mbështetjes për nxënësit me aftësi të kufizuara - Preferenca që fëmijët të angazhohen në aktivitete që gjenerojnë të ardhura - Në disa raste, frika për sigurinë apo 'nderin' e vajzave

Mësuesit, drejtorët dhe personeli tjetër i shkollës	- Nxënësit kanë zgjedhur një drejtim arsimor që nuk përputhet me dëshirat apo kompetencat e tyre - Mungesa e aftësive të nxënësve si komunikimi, aftësitë sociale, organizimi, të mësuarit për të mësuar... - Nxënës të pamotivuar - Mungesa e informacionit mbi përvojën e mëparshme arsimore të nxënësve dhe rreziqet e braktisjes - Mungesa e informacionit për rrethanat e familjeve - Mungesa e trajnimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe me aftësi të kufizuara - Mungesa e koordinimit me institucionet e arsimit bazë dhe me agjencitë dhe profesionistët e sektorëve të tjerë (shërbimet sociale, autoritetet lokale, etj.)
--	---

Tabela 1: Shembuj të barrierave për tranzicionin e lehtë në arsim

Shembuj të ndërhyrjeve për të mbështetur tranzicionet arsimore

Më poshtë është një listë me shembuj konkretë të ndërhyrjeve që mbështesin tranzicionin arsimor. Ndërlidhja me autoritetet lokale ose shërbimet e jashtme për të rritur mbështetjen për nxënësit është thelbësore.

Pesë fusha të tranzicionit shkollor	Lloji i ndërhyrjeve
Administrative	Menaxhimi i përgjithshëm i procesit të tranzicionit - Lidhja dhe koordinimi ndërmjet shkollave - Transferimi i të dhënave/informacioneve - Informacioni për shkollën dhe formularët për prindërit/nxënësit - Mbështetja e prindërve/nxënësve për plotësimin e formularëve, etj.
Sociale dhe personale	Krijimi i lidhjeve ndërmjet nxënësve/prindërve dhe shkollës së tyre të re para dhe menjëherë pas transferimit: - Takime me prindër dhe nxënës, ditë të hapura, takime hyrëse etj. - Prezantimi i grupeve të reja të nxënësve (vizita në shkollë, ndërtimi i ekipit, mentorimi i bashkëmoshatarëve, këshillimi nga një mësues etj.) - Mundësi që nxënësit të diskutojnë në grup shqetësimet e tyre rreth tranzicionit shkollor (para përfundimit të vitit shkollor / në fillim të vitit të ri shkollor). - Mentorimi nga mësuesit/ dhe këshillimi nga moshatarët Orientim karriere: - Nxënësit mbështeten të kuptojnë talentet e tyre, çfarë u pëlqen të bëjnë, pritshmëritë, bindjet e tyre për punën dhe kompetencat, etj. - Informacion, këshillim, praktikë pune, ftesë profesionistësh në shkollë etj. - Mbështetja e nxënësve në përzgjedhjen e lëndëve në lidhje me pikat e forta, nevojat, kërkesat e diplomimit dhe planet e mundësive të jetës

Pesë fusha të tranzicionit shkollor	Lloji i ndërhyrjeve
Pedagogjike dhe kurrikulare	Përmirësimi i vazhdimësisë së kurrikulës ndërmjet niveleve arsimore dhe krijimi i një kuptimi të përbashkët se si u jepet mësim dhe mësojnë nxënësit: • diskutim mes mësuesve ndërmjet shkollave të mesme të ulëta/të larta/AFP • aktivitete të përbashkëta trajnimi me mësues nga nivele të ndryshme arsimore
Të mësuarit	Mbështetja e të mësuarit: • Sigurimi i aktiviteteve mbështetëse të të nxënit (në të dyja anët e tranzicionit midis cikleve shkollore, si forcimi i kompetencave specifike akademike ose socio-emocionale që janë parakushte për nivelin e ardhshëm të arsimit) • Realizimi i kurseve/workshop-eve 'të mësuarit për të mësuar/studiuar' • Inkurajimi i ndihmës në mësim prej bashkëmoshatarëve dhe grupeve të studimit të drejtuara nga nxënësit • Përforsimi i lidhjeve ndërmjet arsimit/programeve mësimore dhe mjeteve të jetesës/qasjes nga fillimi dhe bërjes së mësimit të përshtatshëm për qëllimet e karrierës së nxënësve • Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve dhe nxënësve për arritjet, talentet dhe nevojat
Sigurimi i mbështetjes	Sigurimi që ofrimi i mbështetjes të mos ndërpritet gjatë gjithë fazës së tranzicionit, siç është mbështetja për nevoja të veçanta arsimore, mbështetja nga specialistë ose organizata brenda dhe jashtë shkollës Planet e Tranzicionit mund të jenë të dobishme në disa raste për nxënësit me rrezik shumë të lartë të braktisjes, për të përshkruar të gjithë mbështetjen e nevojshme nga profesionistë të ndryshëm gjatë periudhës së tranzicionit.

Tabela 2: Shembuj të ndërhyrjeve që mbështesin tranzicionin arsimor

Burimi: Përshtatur prej <http://www.headteacher-update.com/best-practice-article/working-together-for-a-smooth-transition/145260>

Kriteret e suksesit për një tranzicion më të lehtë arsimor

Ekzistojnë tre kriteret e një procesi efektiv tranzicioni:

- **Përshtatja sociale**
Përshtatja sociale ka të bëjë me suksesin në krijimin e miqësive të reja mes nxënësve dhe treguesit e vetëbesimit të lartë.
- **Përshtatja institucionale**
Përshtatja institucionale ka të bëjë me përshtatjen e mirë të nxënësve në shkollën e tyre të re dhe të mësuarit me rutinat, sistemet dhe strukturat e shkollës.
- **Interesi dhe vazhdimësia e kurrikulës**

Interesi dhe vazhdimësia e kurrikulës ka të bëjë me përgatitjen e nxënësve për nivelin dhe stilin e ngarkesës që do të hasin në shkollën e re, si dhe sfidimin dhe angazhimin në mënyrë adekuate për të ndërtuar mbi progresin që kanë bërë në ciklin e mëparshëm arsimor.

!	Dhënia e mundësive për nxënësit me sjellje të dobët ose me 'reputacion negativ' për të patur një fillim të ri pas një tranzicioni arsimor është i rëndësishëm në parandalimin e braktisjes së shkollës. Tranzicioni është një mundësi për një fillim të ri, për të marrë përgjegjësi të reja dhe për të krijuar zakone të reja.
---	---

!	Shkollat e AFP-së kanë një përqindje të lartë nxënësish në rrezik të braktisjes në disa vende, veçanërisht ata nxënës që ndihen të pasigurtë për aftësitë e tyre akademike. Ndërhyrjet e mëposhtme mund të kontribuojnë në kontekstualizimin e të mësuarit dhe motivimin e të rinjve të paangazhuar: • Vlerësimi i drejtimit arsimor të zgjedhur në fillim të vitit, duke krijuar lidhje me profesionistë dhe mundësi për arsimim të mëtejshëm; • Orientim karriere dhe mbështetje për aksesin në drejtimet profesionale në sektorë të ekonomisë me performancë të mirë; • Zhvillimi i planit të karrierës (identifikimi i qëllimeve të karrierës dhe hapave për t'i arritur ato); • Skemat e mentorimit profesional (lidhja me bizneset dhe shoqatat profesionale); • Biseda dhe ndërveprim me profesionistët; • Biseda dhe ndërveprim me ish-nxënës; • Projektet shkollore të bazuara në aftësitë e sipërmarrjes, biznesit, etj.
---	--

Reflektim


1. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen grupet e reja të nxënësve në shkollën tuaj?
2. Cilat janë shqetësimet kryesore të nxënësve dhe prindërve të tyre përpara se të regjistrohen në AFP?

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin e shkollës suaj me Detyrën 1.

MJETI 2. LIDHJA ME SHKOLLËN DHE PJESËMARRJA E NXËNËSVE

Ndjenja e përkatësisë në shkollë (lidhja me shkollën) ka të bëjë me ndjenjën e të qenit i pranuar, i pëlqyer, i lidhur dhe mbështetur në mënyrë holistike si individ nga mësuesit, stafi tjetër i shkollës, bashkëmoshatarët dhe ndjenjën e të qenit pjesë e komunitetit të shkollës.



Grafiku 2: Lidhja me shkollën dhe braktisja

Burimi: Përshtatur nga McLaughlin, 2015

Hulumtimet tregojnë se ndjenja e përkatësisë me shkollën është një faktor mbrojtës në lidhje me braktisjen e shkollës. Ndërtimi i ndjenjës së përkatësisë dhe lidhjes me shkollën në përgjithësi është një proces që përfshin disa faktorë, duke përfshirë mjedisin e përgjithshëm të të nxënësve dhe klimën e shkollës, dhe inkurajimin e zërit të nxënësve, marrëdhëniet konstruktive të të rriturve dhe mbështetjen prej tyre, dhe rrjetet e bashkëmoshatarëve dhe mbështetjen në shkollë.

Pjesëmarrja e nxënësve, zëri dhe agjencia

Konventa për të Drejtat e Fëmijës thotë se çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë pikëpamjet, ndjenjat dhe dëshirat e tij për të gjitha çështjet që e ndikojnë, gjithashtu të konsiderohen dhe merren seriozisht pikëpamjet e tij.

Në mjedisin e shkollës, kjo do të thotë të ndash mendime mbi mjedisin mësimor, çështjet e mësimdhënies dhe pjesëmarrjen në instancat dhe proceset vendimmarrëse si procesi i vetëvlerësimit të shkollës, planifikimi i zhvillimit të shkollës dhe çështje të tjera të jetës shkollore.

Në kuadër të parandalimit të braktisjes dhe rritjes së lidhjes me shkollën, pjesëmarrja e nxënësve ka të bëjë me inkurajimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së nxënësve në rrezik braktisje në jetën dhe qeverisjen e shkollës.

Kjo mund të bëhet përmes heqjes së barrierave për pjesëmarrje dhe vendosjes së akomodimit të arsyeshëm në mënyrë që të gjithë nxënësit të mund të marrin pjesë, dhe duke mbështetur në mënyrë aktive pjesëmarrjen e nxënësve më të pafavorizuar.

Për të inkurajuar pjesëmarrjen e nxënësve në rrezik braktisjeje, shkollat mund të:

- Mbledhin informacion mbi pikëpamjet e nxënësve, përmes anketave, fokus grupeve, bisedave joformale dhe konsultimeve të drejtuara nga nxënësit;
- Komunikojnë me nxënësit se si shkollat po i marrin parasysh pikëpamjet e tyre;
- Përfshijnë nxënësit në disavantazh në instancat vendimmarrëse;
- Nxisin pjesëmarrjen e nxënësve në disavantazh dhe atyre të rrezikuar nga braktisja në këshillat e nxënësve;
- Organizojnë një konsultim në nivel shkolle mbi barrierat ndaj pjesëmarrjes për nxënësit e marginalizuar ose vulnerabël dhe si t'i eliminojnë ato;
- I vendosin përgjegjësi nxënësve në rrezik braktisjeje, të tilla si drejtimi i një aktiviteti të grupit të bashkëmoshatarëve, një klub shkolle ose një projekt shkollor dhe përzgjedhja e tyre si mentorë ose tutorë për nxënësit më të vegjël;
- Sigurojnë që nxënësit e marginalizuar dhe ata që janë në rrezik të braktisjes të marrin pjesë në aktivitete, ngjarje sportive dhe aktivitete jashtëshkollore;
- Sigurojnë që nxënësit e marginalizuar dhe ata që janë në rrezik të braktisin të marrin pjesë në projekte shkollore, të tilla si (i) projektet e sipërmarrjes ose projektet krijuese që angazhojnë të rinjtë në një mënyrë kuptimplotë dhe që inkurajojnë interesin për atë që ata prodhojnë ose arrijnë dhe (ii) projektet që lidhin shkolla në komunitetin lokal, vendin e punës apo botën më gjerë, për të rritur angazhimin dhe motivimin në mësim.

Ndërtimi i lidhjes

Shkollat mund të zbatojnë një sërë aktiviteteve për të krijuar lidhjen, duke përfshirë forcimin e marrëdhënieve të besueshme dhe konstruktive staf-nxënës, inkurajimin e aktiviteteve mbështetëse të bashkëmoshatarëve dhe mbështetjen e përgjithshme për mirëqenien. Aktivitete të tjera përfshijnë:

- Aktivitete ekstrakurrikulare (kulturore, artistike, sportive, rekreative, në natyrë...)
- Promovimi i ndërveprimeve joformale ndërmjet nxënësve përgjatë viteve, nxënësve dhe stafit, nxënësve dhe profesionistëve/bizneseve/sipërmarrësve...
- Mundësi për të marrë pjesë në projekte (shkollore ose komunitare) që u mundësojnë nxënësve të punojnë në mënyrë bashkëpunuese dhe inovative për problemet konkrete të shkollës ose komunitetit, të propozojnë zgjidhje dhe të bëjnë ndryshim.
- Aktivitete të drejtuara nga nxënësit, pra aktivitete që hartohen dhe zbatohen nga nxënësit për nxënësit, me mbështetjen e shkollës kur nevojitet.

Nivelet e pjesëmarrjes së nxënësve

Ka shumë lloje të ndryshme të pjesëmarrjes. Nivelet e pjesëmarrjes së nxënësve (më poshtë) bëhen gjithnjë e më domethënëse dhe të vërteta ndërsa kaloni nga niveli i parë (Manipulimi) tek niveli i tetë (Vendime të iniciuara nga fëmijët, Vendime të përbashkëta me të rriturit). Tre nivelet e para nuk mund të konsiderohen vërtet pjesëmarrëse, por secili nga pesë nivelet e mëtejshme është i përshtatshëm për fëmijët bazuar në aktivitetin në të cilin angazhohen dhe në shkallën në të cilën kanë evoluar aftësitë e tyre pjesëmarrëse dhe vendimmarrëse.

8 VENDIME TË INICIUARA NGA FËMIJËT, VENDIME TË PËRBASHKËTA ME TË RITURIT

- Fëmijët i iniciojnë vetë projektet, ndërsa vendimmarrja ndahet me të rriturit. Fëmijët kanë fuqinë për të bërë ndryshime pozitive bazuar në pikëpamjet dhe idetë e tyre, duke u mbështetur në ekspertizën dhe ndihmën e të rriturit. Të rriturit nuk imponojnë pikëpamjet e tyre ose nuk përpiqen të drejtojnë projektin; përkundrazi dëgjojnë, vëzhgojnë dhe veprojnë për idetë dhe planet e të rinjve.

7 VENDIME TË INICIUARA DHE DREJTUARA NGA FËMIJË

- Fëmijët e iniciojnë dhe drejtojnë vetë projektin, me të rriturit që luajnë vetëm një rol mbështetës. Të rriturit u ofrojnë fëmijëve mjetet, burimet dhe informacionin që u nevojitet për të realizuar pikëpamjet dhe idetë, por vendimmarrja i përket vetëm fëmijëve.

6 VENDIME TË INICIUARA NGA TË RRRITURIT, VENDIME TË PËRBASHKËTA ME FËMIJËT

- Të rriturit nisin veprime, por ndajnë fuqitë vendimmarrëse me fëmijët. Ndërsa ideja fillestare mund të vijë nga të rriturit, fëmijët janë të përfshirë në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e një projekti të caktuar.

5 TË KONSULTUARA DHE INFORMUARA

- Fëmijët japin këshilla për projektet që drejtohen nga të rriturit. Fëmijët nuk përfshihen në vendimmarrje, por u kërkohet të ndajnë idetë që do të ndikojnë vendimet e të rriturve. Fëmijët duhet të informohen se si do të jenë këshillat e tyre të përdoren dhe të ndërgjegjësohen për rezultatet e vendimeve të marra nga të rriturit.

4 TË KAKTUARA DHE INFORMUARA

- Fëmijëve u caktohet një rol specifik në një projekt nga të rriturit. Fëmijët i kuptojnë qëllimet e projektit dhe kush i mori vendimet në lidhje me përfshirjen e tyre dhe pse. Fëmijëve u jepet një rol kuptimplotë, për të cilin ata dalin vullnetarë vetëm pasi të kenë një kuptim të qartë të objektivave.

3 TOKENIZËM

(PJESËMARRJE JOEFEKTIVE)

- Fëmijëve u kërkohet të flasin ose të marrin pjesë në një projekt të drejtuar nga të rriturit pa i kuptuar plotësisht çështjet, arsyetimin e projektit ose atë që kontributi i tyre i shton projektit. Duket se atyre u jepet një zë, por në realitet ata kanë pak zgjedhje se si të marrin pjesë. Për shembull, fëmijëve mund t'u kërkohet të ulen në një panel pa shpjegim se si u zgjodhën dhe me pak kohë për t'u përgatitur.

2 DEKOR

(PJESËMARRJE JOEFEKTIVE)

- Fëmijët përdoren për të mbështetur një kauzë të udhëhequr nga të rriturit duke u veshur, duke vepruar ose duke performuar në një mënyrë të caktuar. Ata nuk kontribuojnë në organizimin ose planifikimin e ngjarjes, përkundrazi pjesëmarrja e tyre përdoret kryesisht për të nxitur një emocion nga palë të interesuara ose audiencia specifike.

1 MANIPULIMI

(PJESËMARRJE JOEFEKTIVE)

- Të rriturit përdorin fëmijët për të promovuar një kauzë dhe pretendojnë se kauza është frymëzuar ose mbështetur nga fëmijët, ndërkohë që ata nuk e kuptojnë kauzën. Nëse fëmijët nuk i kuptojnë çështjet ose se si mund të kontribuojnë veprimet e tyre, pjesëmarrja e tyre

mund të shihet si manipulim.

MJETI 3. MARRËDHËNIET POZITIVE NXËNËS-MËSUES

Fëmijët nuk mësojnë nëse nuk ndjejnë përkujdesje. Me fjalë të tjera, arritja e tyre është e lidhur me mirëqenien. Shpesh janë nxënësit që ne njohim më së paku ata që kanë më shumë nevojë për marrëdhëniet pozitive me të rriturit në një shkollë.

Mjedise mbështetëse për marrëdhënie pozitive mësues-nxënës

Më poshtë janë disa parime të përgjithshme të mjediseve mbështetëse (përshtatur nga UNICEF (2017), McLaughlin (2015) dhe Bergin dhe Bergin (2009). Ndërsa këto parime i përfitojnë të gjithë nxënësit, ato janë veçanërisht të rëndësishme për nxënësit në rrezik të braktisjes ose që janë shkëputur me shkollën dhe arsimin.

Mjediset ku nxënësit dëgjohen – nxënësit të jenë në gjendje të shprehen në mjedise të sigurt ku nxitet zëri i tyre, duke i angazhuar ata në vendimmarrje dhe duke dëgjuar pikëpamjet e tyre.

Mjedise ku nxënësit respektohen – për atë se kush janë ata si individë, me prejardhjen dhe nevojat e tyre, dhe mbështeten si në aspektin akademik ashtu edhe për çështje joakademike.

Mjedise ku respekti i ndërsjellë është në thelb të marrëdhënieve mes të rriturve dhe të rinjve, ku komunikimi është i hapur dhe i ndërsjellë midis nxënësve dhe të rriturve.

Mjedise ku disiplina e shkollës është jo shtrënguese dhe e bazuar në zgjidhjen e konflikteve dhe strategjitë e ndërmjetësimit, ku trajtohen marrëdhëniet e vështira në mënyrë që ato të rregullohen.

Mjedise që nxisin pritshmëri të larta nga të gjithë nxënësit dhe që mbështesin autonominë e tyre, duke ofruar zgjedhje dhe duke iu përgjigjur interesit dhe zërit të nxënësve.

Mjedise që ofrojnë një sërë mundësish për promovimin e marrëdhënieve mësues-nxënës, duke përfshirë (i) mundësitë e socializimit si ekskursionet dhe ngjarjet joakademike, (ii) mundësitë e komunikimit joformal, si vaktet e përbashkëta ose aktivitetet jashtëshkollore, dhe (iii) skemat e mentorimit, një strategji e dëshmuar efektive për të parandaluar shkëputjen e nxënësve nga arsimi duke forcuar gjithashtu marrëdhëniet mes mësuesve dhe nxënësve.



Ndërveprimi me stafin. Kur djemve u mungojnë modele pozitive, mundësitë për ndërveprime pozitive me stafin e gjinisë mashkullore mund të jenë një strategji e dobishme.

Zhvillimi, mirëmbajtja dhe rritja e mjediseve të tilla mund të jetë sfiduese në baza ditore, veçanërisht kur nxënësit demonstrojnë emocione të forta ose sjellje sfiduese.

Reflektim

1. Individualisht, merrni listën e nxënësve tuaj këtë vit (ose të njërës prej klasave tuaja). Vlerësoni shpejt sa mirë ndiheni se i njihni në një shkallë 1–3 (1 = jo shumë mirë, 2 = mjaft mirë dhe 3 = shumë mirë). Për këtë ushtrim, të dish do të thotë të njohësh çfarë u pëlqen jashtë shkollës, pasionet e tyre, nga çfarë kanë frikë, etj.
2. Çfarë 1, 2 dhe 3 keni në listën tuaj? A ju befason kjo?
3. Cilët janë nxënësit që nuk i njihni shumë mirë? Çfarë kanë të përbashkët? A rrezikohen këta nxënës të braktisin shkollën apo të jenë të marginalizuar në ndonjë mënyrë?

Kuptimi i paragjyqimeve të mësuesve

Paragjykimet delikate, të tilla si paragjykimet gjinore dhe konjitive mund të ndikojnë në perceptimet dhe marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve por edhe midis nxënësve dhe të kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mosangazhimin në shkollë.

Ne jemi të gjithë njerëz, mësuesit, stafi i shkollës dhe nxënësit nuk bëjnë përjashtim, dhe si të tillë mund të projektojmë stereotipe apo paragjyqime, me vetëdije apo pa vetëdije.

Stereotipet dhe paragjykimet shpesh çojnë në diskriminim, i cili mund të rezultojë në bullizëm dhe të ndikojë ndjeshëm në mirëqenien e nxënësve, të çojë në probleme të shëndetit mendor dhe të çojë ose kontribuojë në braktisjen e shkollës.

Duke u bërë më të vetëdijshëm për paragjykimet tona, ne mund të kuptohemi më mirë, të angazhohemi dhe të komunikojmë me të tjerët, në një mjedis vërtet gjithëpërfshirës dhe mbështetës.

“Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se pritshmëritë, qëndrimet dhe gjuha e tyre mund të kenë një impakt dhe ndikim të rëndësishëm te nxënësit dhe familjet.” (Komisioni Evropian (2015))

Paragjykimi është një prirje **për** ose **kundër** diçkaje ose dikujt. Ka shumë lloje të ndryshme paragjyqimesh.

Ne të gjithë kemi **paragjyqime të pavetëdijshme** të cilat bazohen në mënyrën se si truri ynë e percepton, filtron dhe kategorizon informacionin, gjë që ndikon në mënyrën se si ne i shohim gjërat dhe bëjmë gjyqime. Si njerëz, ne kemi evoluar për t'i kategorizuar njerëzit dhe preferojmë njerëzit 'si ne'. Kjo ndikohet edhe nga edukimi, kultura dhe përvojat tona personale.

Kur kemi një paragjykim të pavetëdijshëm për një person ose një grup njerëzish, kjo rezulton në sjellje të vogla shumë delikate, të tilla si kushtimi më pak ose më shumë vëmendje i asaj që një nxënës po thotë ose të buzëqeshurit më pak ose më shumë.

Paragjykimet e forta të mësuesve mund të çojnë në favorizim ose neglizhencë ndaj nxënësve. Kjo mund të përkthehet në pritshmëri më të ulëta për disa nxënës ose duke ofruar më pak mundësi për tëdhe për t'u lidhur me të tjerët. Të qenit i vetëdijshëm për paragjykimet është e rëndësishme, pasi ato mund të pengojnë zhvillimin, suksesin dhe arritjet e nxënësit.

Paragjykimet e mësuesve, **kundër** ose **në favor** të një grupi, mund të përfshijnë:

- **Paragjykim gjinor** – paragjykim në favor ose kundër vajzave dhe djemve.
- **Paragjykimi racor ose etnik** – paragjykim në favor ose kundër një race ose grupi etnik të caktuar.

- **Paragjykimi i disavantazhit** – paragjykim në favor ose kundër nxënësve pak a shumë të pafavorizuar.
- **Paragjykimi ndaj aftësisë së kufizuar (Nxënësi me Nevoja të Veçanta Arsimore)** – paragjykim në favor ose kundër nxënësve me NVA.
- **Paragjykimi i pajtueshmërisë** – paragjykim në favor ose kundër nxënësve të perceptuar si më të shoqërueshëm (të zhurmshëm) dhe të sjellshëm (të qetë).

Paragjykimet ndikojnë në mënyrë delikate në sjelljen e mësuesve, ndikojnë në mënyrën se si ata ndërveprojnë me nxënësit, në mënyrën se si ata i përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore, mënyrën se si i vlerësojnë detyrat dhe nxënësit edhe mënyrën se si ata flasin për ta me prindërit dhe stafin tjetër të shkollës.

Paragjykimet konjitive janë modele të përsëritura gabimi në të menduarit bazuar në besimet dhe përvojat tona që ndodhin kur përpunojmë dhe interpretojmë informacionin dhe që ndikojnë në gjykimin dhe vendimet tona.

Paragjykimet e zakonshme konjitive përfshijnë:

- **Paragjykimi i ngjashmërisë** – prirje për t'u afruar me njerëz si ne, të cilët ndajnë të njëjtat cilësi si ne.
- **Efekt i halo** – kur një aspekt pozitiv që ne perceptojmë për një individ na bën të mendojmë se gjithçka për personin është e mirë.
- **Efekt i horn** – kur perceptimi ynë për një person tjetër ndikohet në mënyrë të padrejtë nga një tipar i vetëm negativ.
- **Paragjykimi i konfirmimit** – tendenca për të kërkuar dhe besuar informacion që konfirmon besimet paraekzistuese.



Efekt i Pygmalion

Eksperimenti Rosenthal, i kryer për herë të parë në vitet '60, tregon se si pritshmëritë e mësuesve mund të ndikojnë në performancën e nxënësve. Rosenthal bëri që nxënësit e shkollave fillore t'i nënshtroheshin një Testi të Aftësive të Përgjithshme në fillim të vitit akademik dhe u tha mësuesve se nxënësit do të ndaheshin sipas shkallës me të cilën pritej të mësonin. Në realitet, ndërsa nxënësit ishin testuar vërtet, grupet e ndara me potencial të lartë dhe potencial të ulët të të mësuarit u zgjodhën krejtësisht në mënyrë të rastësishme. IQ-ja e nxënësve u testua sërish në fund të vitit. Rezultatet treguan se performanca u përmirësua shumë më tepër në grupin me 'potencial të lartë' në krahasim me grupin me 'potencial të ulët', pavarësisht nga IQ bazë. Për më tepër, ndryshimi ishte shumë më i madh, sa më i vogël të ishte fëmija.



Të bëhemi të vetëdijshëm dhe të pranojmë paragjykimet tona dhe se si këto mund të ndërhyjnë në marrëdhëniet tona me nxënësit apo edhe të pengojnë suksesin e tyre është *hapi i parë*.

Reflektim

1. Vini re se si ndërveproni ndryshe në klasë me djemtë dhe vajzat, nxënësit me prejardhje të ndryshme etnike ose socio-ekonomike dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Çfarë sjelljesh delikate mund të identifikoni që mund të zbulojnë një paragjykim të pavetëdijshëm ose konjitiv?
2. A keni vënë re ndonjëherë se vlerësoni një detyrë ose test më mirë sepse ju pëlqen një nxënës ose ndiheni të lidhur me një nxënës të caktuar?

MJETI 4. MENAXHIMI I SJELLJES SFIDUESE

Kuptimi i nevojave të adoleshentëve

Koncepti i nevojave njerëzore është kompleks dhe i debatuar në literaturë. **Nevojat njerëzore shpesh përshkruhen si shtytëse dhe motive të sjelljes së njerëzve.**

Disa shpjegojnë se nevojat njerëzore ekzistojnë objektivisht, të tjerë se ato nuk mund të shkëputen nga vlerat dhe këndvështrimet njerëzore. Nevojat njerëzore mund të përkufizohen si 'diçka që është *e nevojshme* që diçka tjetër të ndodhë' (Ife, 2012).

Situata 1.

Veprimtari e mësuesve në role të nxënësve të tyre. (Situatë e provuar me grupe nxënësish).

“Cilat janë nevojat kryesore të nxënësve , të domosdoshme për t'u njohur si kusht i parandalimit të braktisjes.”

1. Secili përcakton me fjalë ose në letër identitetin e tij.
2. Sipas rolit, përcaktohen nevojat specifike të secilit si kusht i suksesit.

Ndahen nevojat:

- Fizike- për të jetuar, nevoja të zhvillimit, apo të kërkuara nga nxënësit në mënyrë të veçantë.
- Emocionale dhe shpirtërore që lidhen me mënyrën e të jetuarit, zhvillimi i plotë sipas moshës dhe botës emocionale.
- Nevoja intelektuale ose mendore.

Si mendoni se duhet parandaluar braktisja? Cilët persona të shkollës suaj mendoni se mund të përfshihen në këtë proces?

- Ju personalisht
- Drejtori
- Mësuesit
- Psikologu
- Njësia e zhvillimit
- Komuniteti

Hierarkia e nevojave e Maslow

Hierarkia e nevojave e *Maslow* është një kornizë e thjeshtë që përmban pesë dimensionet, duke përfshirë:

- Katër nevojat themelore: fiziologjike, për siguri, sociale (dashuri dhe përkatësi) dhe vlerësim; dhe,
- Një nevojë për rritje: aktualizim, e cila mund të kuptohet si përmbushje.

Nevojat për vetë-aktualizim	realizimi i potencialit personal , vetë-përmbushja, kërkimi i rritjes personale dhe përvojave kulmore
Nevojat për vlerësim	arritjet, mjeshtëria, pavarësia, statusi, dominanca, prestigji, respekti për veten, respekti nga të tjerët

Nevojat sociale	dashuria dhe përkatësia si miqësia, intimiteti, afeksioni dhe dashuria - nga grupi i punës, familja, miqtë.
Nevojat për siguri	mbrojtja nga rreziku, siguria, rendi, ligji, stabiliteti, liria nga frika
Nevojat fiziologjike	ajri, ushqimi, uji, strehimi, ngrohtësia, gjumi

Tabela 3: Nevojat njerëzore sipas Maslow

Përshtatur prej: McLeod (e përditësuar në 2018)

Pesë dimensionet e nevojave nga Maslow janë të dobishme, megjithatë është e rëndësishme të kuptohet se njerëzit, fëmijët dhe adoleshentët në veçanti, kanë nevoja të shumta në dimensione të ndryshme në të njëjtën kohë dhe se këto nevoja kërkojnë përbushje të vazhdueshme. Prandaj, nocioni i një hierarkie të nevojave nuk konsiderohet më i vlefshëm.

Nevojat ndikojnë në mënyrën se si ne sillemi, në mënyrë që nevojat tona të përbushen. Prandaj, kuptimi i nevojave themelore të nxënësve është thelbësor për të kuptuar sjelljen.

Kur nevojat e tyre nuk plotësohen, nxënësit mund të ndihen të tensionuar dhe të shqetësuar, e kjo do të ndikojë në qëndrimin dhe sjelljen e tyre në shkollë, ndaj mësimit dhe shkollës. Për shembull:

Nevojat e papërbushura	Ndikimi i mundshëm
Nxënësi ndihet i uritur ose i lodhur	<i>mësimi është i parëndësishëm për të</i>
Nxënësi ndihet i frikësuar në shtëpi ose në shkollë	<i>nxënësi është i shqetësuar, armiqësor ose i tërhequr</i>
Nxënësi nuk ndihet pjesë e grupit në shtëpi dhe shkollë	<i>nxënësi është armiqësor me të tjerët, nxënësi kërkon vëmendje, shqetëson klasën</i>
Nxënësi fokusohet në dështime dhe nuk ndihet i vlerësuar	<i>nxënësi ka frikë nga rreziqet dhe dështimet, ndihet i pafuqishëm, i paftë për të përballuar shkollën</i>
Nxënësi nuk ka mundësi të zhvillojë aftësitë e tij, të shprehë mendimin e tij	<i>nxënësi ndihet i mërzhitur ose i pashpresë, shkolla dhe jeta i duket e pakuptimtë</i>

Tabela 4: Nevojat njerëzore të papërbushura dhe ndikimi i tyre i mundshëm

Burimi: Këshilli i Vlerësimit të Kurrikulës dhe Provimeve të Irlandës së Veriut (2014)

Përshtatja e hierarkisë së nevojave të Maslow nga Bélair

Bélair (2009) përshtati hierarkinë e nevojave të Maslow në kontekstin e sjelljes së nxënësve në klasë.

Nevojat	Shembujt
Përkatësia	- Të duash dhe të të duan - Të jesh i sigurt për pranimin e pakushtëzuar nga një person tjetër - Të jesh pjesë e një grupi - Të jesh i pranuar për atë që je dhe jo për atë që bën
Fuqia*	Vetëvlerësimi

Nevojat	Shembujt
	• Mirënjohja prej bashkëmoshatarëve • Ndjenja e të qenit i dobishëm për veten dhe të tjerët • Ndjenja e të qenit kompetent dhe i rëndësishëm
Kënaqësia	• Të argëtohesh, qeshësh, përdorësh humor • Të jesh në gjendje të ndash me të tjerët një eksperiencë • Të jesh i kënaqur nga vetvetja ose nga ajo që ke përfituar
Liria	• Bërja e zgjedhjeve • Pranimi për të hequr dorë nga opsionet që nuk i ke zgjedhur • Të qenit i përgjegjshëm për pasojat e zgjedhjes
Mbijetesa	• Nevojat fiziologjike (të ngrënit, të pirit, gjumi) • Siguria (mbrojtja)

Tabela 5: Hierarkia e nevojave e përshtatur nga Belair

*Manifestimet e pushtetit: (i) pushteti mbi trupin (kujdesi për trupin: ngrënia; personalizimi i trupit, grimi, tatuazhi, stilimi i flokut; abuzimi me trupin: ushqimi, droga, mungesat, gjymtimi); (ii) pushteti mbi mjedisin (shkrimi në tavolina, përplasja e dyerve, shkatërrimi i diçkaje); (iii) fuqia mbi veten dhe të tjerët (të dëgjuarit, të kuptuarit, të rënit dakord dhe të vërtetimit të veprimeve të dikujt).

Kur shkollat nuk janë të vetëdijshme për nevojat e nxënësve, ato nuk mund t'i mbështesin ata, duke i bërë nxënësit të ndiejnë se nevojat e tyre shpërfillen dhe duke kontribuar në mosangazhim.

Reflektim

1. Mendoni për disa situata kur një sjellje e nxënësit nuk ishte e pranueshme për ju.
2. Cila ishte nevoja e nxënësit në momentin e sjelljes?

Përgjigjja ndaj sjelljes sfiduese

Shkaktarët dhe spiralja e veprim-reagimit

Të gjithë ne i përjetojmë ngjarjet dhe bisedat ndryshe. Këto përvoja nxisin mendime, të cilat nxisin ndjenja, të cilat nxisin sjellje. Këto sjellje, nga ana tjetër, shkaktajnë reagime nga të tjerët. Kjo krijon një spirale (shih më poshtë) e cila mund të jetë pozitive ose negative.




Figura 1: Spiralja e veprim-reagimit

Burimi: Qeveria Skoceze (2008)

Më poshtë është një shembull i thjeshtë se si funksionon spiralja në praktikë. Vëzhgoni se si një hap të çon në tjetrin.




Figura 2: Shembulli i një spiraleje negative

Në të kundërt, më poshtë është një shembull se si mund të priset spirala negative.




Figura 3: Shembulli i një spiraleje pozitive

Reflektim

Mendoni për një situatë që ju stresoi ose për të cilën ishit të pakënaqur kohët e fundit në klasën tuaj, si për shembull diçka që një nxënës tha ose bëri që ju e patë të papërshtatshme. Përdorni modelin Spirale dhe pyetjet udhëzuese më poshtë për ta analizuar atë.

1. Përshkruani situatën me një fjali (d.m.th. faktin, si p.sh. çfarë bëri ose tha një nxënës).
2. Çfarë menduat për situatën?
3. Si ju bëri të ndiheni? Përshkruani ndjenjën tuaj kryesore për situatën.
4. Çfarë bëtë? Përshkruani sjelljen/veprimet/përgjigjen tuaj ndaj situatës.
5. Çfarë reagimesh shkaktoi kjo sjellje te nxënësi(t)? Për veten tuaj?
6. Çfarë duhet të ndryshojë në hapat 2-3-4 që spirala të bëhet më pak negative. Tregoni disa mendime, ndjenja dhe sjellje alternative që do ta kishin bërë hapin 5 një rezultat më pozitiv?

Biseda të hapura për sjelljen e nxënësve

Kur kuptojmë se ndërveprimet bazohen në mendime dhe ndjenja siç përshkruhet në spiralen e mësipërme, mund të shohim se si situatat konfliktuale mund të përshkallëzohen shpejt. Megjithatë, duke ndryshuar mënyrën se si e perceptojmë situatën dhe reagojmë ndaj sjelljeve sfiduese, ne mund

të luajmë një rol për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se si funksionon modeli veprim-reagim dhe t'i ndihmojmë ata të bëhen më të vetëdijshëm se si i kontrollojnë emocionet e tyre.

Më poshtë është një proces i thjeshtë hap pas hapi për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit të flasin për një episod të sjelljes së papërshtatshme. Baza e komunikimit të hapur është të kuptosh se çfarë po përpigjej të komunikonte nxënësi kur përdor një sjellje specifike, në mënyrë që të ishte në gjendje ta adresonte këtë nevojë përmes mënyrave alternative.

Hapat	Shembuj të pyetjeve
1. Kërkimi për qëllimin e nxënësit	• Çfarë kërkoje/dëshiroje (me këtë sjellje)? • Pse është aq e rëndësishme [marrja e asaj që dëshiroje]?
2. Kuptimi i sjelljes	• Çfarë veprimesh zgjodhe për të marrë atë që dëshiroje?
3. Vlerësimi i nivelit të kënaqësisë së nxënësve në lidhje me rezultatet e sjelljes së diskutuar	• A ka funksionuar? • A more rezultatet që dëshiroje? • A është e kënaqshme (për ty? Mua? Klasën?) • A je i/e kënaqur me rezultatet? • A do të japë përdorimi i sjelljes X/veprimit X mundësi të arsyeshme për të marrë atë që dëshiron? • Si ndihesh në këtë situatë?
4. Kërkimi i zgjidhjeve më të mira (për nxënësin dhe mësuesin)	• A je gati të bësh diçka ndryshe? • Si mund ta marrësh atë që dëshiron ndryshe? • A do të kërkojmë së bashku për ide dhe zgjidhje që janë më të kënaqshme si për ty ashtu edhe për mua/klasën?

Tabela 6: E folura për një episod të sjelljes së papërshtatshme: një proces hap pas hapi

Burimi: Përshtatur prej Bélair (2009)

Nxënësit që ndihen të mbështetur nga të rritur të rëndësishëm në jetën e tyre ka të ngjarë të jenë më të angazhuar në shkollë dhe mësim.

!	Të kuptuarit e nxitësve tanë emocionalë dhe reflektimi se si mendimet dhe emocionet tona ndikojnë në mënyrën se si sillemi në situata të veçanta është një aftësi e dobishme për t'u zhvilluar, për t'iu përgjigjur sjelljeve sfiduese në një mënyrë të qetë dhe mbështetëse.
---	---

!	Mos harroni të emërtoni dhe etiketoni sjelljen dhe jo personin. Kjo mund t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë se mund të ndryshojnë sjelljen e tyre ndaj të tjerëve. Për shembull, 'kur ti bën X, unë ndihem Y'.
---	---

MJETI 5. MBËSHTETJA E BASHKËMOSHATARËVE

Mundësimi i lidhjeve me bashkëmoshatarët dhe mekanizmat mbështetës të bashkëmoshatarëve janë një pjesë kyçe e rritjes së ndjenjës së përkatësisë dhe lidhjes me shkollën.

Në kontekstin e braktisjes së shkollës, nxënësit mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e një kodi moral të shkollës që i përgjigjet braktisjes dhe në hartimin ose kontributin në aktivitetet e parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes.

Aktivitetet mbështetëse të bashkëmoshatarëve që janë dëshmuar efektive në kontekstin e parandalimit të braktisjes përfshijnë:

- **Mentorimi i bashkëmoshatarëve** – Një nxënës mentoron një nxënës tjetër. Nxënësit në rrezik të braktisjes mund të mentorohen nga nxënës të tjerë ose të mentorojnë nxënës të tjerë (*shih shembullin në SHBA dhe Mbretëri e Bashkuar më poshtë*).
- **Studim me bashkëmoshatarët** – Një nxënës i shpjegon mësimin një tjetri në lëndë të caktuara. Kjo mund të bëhet në të njëjtën klasë (një nxënës me nota më të mira që udhëheq një nxënës me nota më të ulëta), ose në të gjitha klasat (p.sh., një nxënës nga një klasë më e lartë që udhëheq një nxënës nga një klasë më e ulët - kështu, nxënësit në rrezik të braktisjes mund të marrin përgjegjësi dhe role të reja angazhuese).
- **Skema e miqësisë** – Një nxënës është përgjegjës për akomodimin/përshtatjen e një nxënësi të ri që ka mbërritur në shkollë.
- **Mbledhja e fondeve** – Nxënësit organizojnë aktivitete për mbledhjen e fondeve për të mbështetur aktivitetet sociale në shkollë.

Shumë aktivitete mbështetëse nga bashkëmoshatarët kontribuojnë si në parandalimin e braktisjes së shkollës, ashtu edhe në përmirësimin e aftësive socio-emocionale të nxënësve të përfshirë. Për shembull, mentorimi do të përforcojë aftësitë e marrëdhënieve të të dy nxënësve, ndërkohë që ndihmon të mentoruarin të përmirësojë aftësitë e tij/saj të vetë-menaxhimit.



Kur angazhoni nxënësit në mbështetjen e bashkëmoshatarëve, është e rëndësishme që të mos etiketohen nxënësit 'në rrezik për të lënë shkollën' ose 'të mbetur prapa' dhe të mos zbulohen informacione konfidenciale për situatat individuale të nxënësve.



Mentorimi i bashkëmoshatarëve dhe largimet nga shkolla: Përvojë nga SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar

Bazuar në një përvojë të suksesshme nga SHBA (të cilën fillimisht e financoi Coca-Cola), Mbretëria e Bashkuar ka zbatuar projektin 'Rinia e vlerësuar' në disa rajone. Programi kishte për qëllim të ndihmonte nxënësit e shkollave të mesme në rrezik për t'u shkëputur nga shkolla ose për të performuar dobët, për t'u bërë udhëheqës të fëmijëve të shkollave fillore që kanë nevojë për mbështetje mësimore.

Nxënësit udhëheqës u zgjedhën prej stafit të shkollës dhe morën trajnim dhe mbështetje nga një organizatë bamirëse për të rinjtë. Ata u caktuan në shkollat fillore mesatarisht katër orë në javë dhe merrnin pjesë në një takim javor me koordinatoren në shkollën e tyre. Modeli origjinal amerikan u ndërtua si një sistem shpërblimi ku nxënësve udhëheqës u paguhej një pagë minimale.

Në Mbretërinë e Bashkuar, skema favorizoi shpërblimin e nxënësve udhëheqës përmes eventeve, kuponave për libra dhe pajisjeve shkollore. Një vlerësim i programit të Mbretërisë së Bashkuar tregoi përmirësime për nxënësit udhëheqës, në qëndrimet ndaj të mësuarit dhe rritjes së

vetëbesimit dhe aftësive të komunikimit. Në SHBA, vlerësimi tregoi se projekti kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e braktisjes së shkollës për nxënësit udhëheqës.

Burimi: Trickey et al. (2005); Lehr et al. (2004), nga UNICEF (2017)

MJETI 6. MBËSHTETJA E MIRËQENIES

Kuptimi

Mirëqenia është një koncept kompleks, shumëdimensional që ka shumë përkufizime. Ai përfshin një nivel kënaqësie për cilësinë e jetës që përfshin të mirat materiale dhe jomateriale të jetës. Shumica e përkufizimeve përfshijnë disa dimensione:

- Mirëqenia fizike
- Mirëqenia sociale
- Mirëqenia emocionale
- Mirëqenia psikologjike
- Mirëqenia konjitive

E aplikuar në kontekstin e shkollës, **mirëqenia e nxënësve** ka të bëjë me atë se si nxënësit ndihen dhe funksionojnë personalisht dhe akademikisht. Mirëqenia është e pranishme kur nxënësit kanë aftësitë që u nevojiten për të realizuar potencialin e tyre, ndihen mirë dhe të përmbushur, përballen me streset e ditës dhe 'kanë një ndjenjë qëllimi dhe përkatësie ndaj shoqërisë më të gjerë' (Departamenti Irlandez i Arsimit, 2021; OECD, 2017).

Qasja e gjithë shkollës për mbështetjen e mirëqenies

Përmirësimi i mirëqenies socio-emocionale të nxënësve është pjesë përbërëse e një qasjeje të të gjithë shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe ka implikime për **pesë fusha kryesore** në një shkollë:

- **Udhëheqja** dhe menaxhimi i shkollës;
- **Etosi** i shkollës;
- **Pjesëmarrja** e nxënësve në shkollë;
- **Partneriteti** me prindër dhe aktorë të jashtëm (komunitet, profesionistë nga sektorë të tjerë); dhe
- **Aktivitetet dhe ndërhyrjet mbështetëse të mirëqenies** në shkollë, klasë dhe në nivel individual.

Më poshtë është një listë e aktiviteteve që promovojnë dhe u përgjigjen nevojave të mirëqenies, duke përdorur qasjen me tre nivele për parandalimin e braktisjes.

Niveli 1 – Universal Mbështetje e gjithë shkollës dhe klasës, për të gjithë nxënësit	Promovimi, mbështetja e të mësuarit socio-emocional dhe zhvillimit të aftësive të mirëqenies në të gjithë shkollën • Klimë pozitive dhe gjithëpërfshirëse në shkollë; praktikat gjithëpërfshirëse të shkollës dhe klasës që trajtojnë stigmën dhe diskriminimin • Strategjitë efektive kundër bullizmit dhe parandalimit të dhunës • Pjesëmarrja e nxënësve në qeverisjen e shkollës/jetën shkollore • Marrëdhëniet pozitive të rritur-nxënës në shkollë
--	---

	• Të nxënës socio-emocional i përfshirë në aktivitetet/mësimdhënien e shkollës • Aktivitetet ekstra-kurrikulare • Programe gjithëpërfshirëse të edukimit seksual, që trajtojnë aspektet sociale dhe psikologjike të seksualitetit • Ofrimi i shërbimeve të këshillimit dhe shëndetit mendor me bazat në shkollë • Ndërhijet e psikologëve shkollorë në klasa për të diskutuar shëndetin mendor dhe shkëmbimin e informacionit mbi mbështetjen e disponueshme
Niveli 2 – Mbështetje e synuar për nxënësit në rrezik	Ndërhijet e synuara në nivel shkolle ose klase për të adresuar nevojat e grupeve të veçanta të fëmijëve • Mbështetje socio-ekonomike për nxënësit e pafavorizuar • Identifikimi i nxënësve me shëndet të dobët mendor (p.sh. ankth) dhe promovimi i një kulture të kërkimit të ndihmës midis grupeve që kanë nevojë • Identifikimi dhe sinjalizimi i nxënësve me rreziqe të sigurisë (p.sh. martesa e hershme, abuzimi dhe dhuna) • Mundësi shtesë për ndërtimin e aftësive nëpërmjet aktiviteteve jashtëshkollore në shkollë dhe jashtë shkollës, duke u lidhur me palët e tjera të interesit në komunitet/sectorin privat për të ndjekur interesin e nxënësve • Mbështetje psikologjike në shkollë: 'seanca të rastësishme' gjatë dhe pas orarit të mësimi, mbështetje psikologjike në grupe të vogla • Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive individuale me nxënësit • Mentorim (nga një i rritur ose nga një bashkëmoshatar) • Puna me prindërit
Niveli 3 – Mbështetje individuale e përshtatur për nxënësit në rrezik të lartë të braktisjes ose me nevoja komplekse	Ndërhijet të përshtatura në shkollë dhe më gjerë për të adresuar nevojat komplekse të disa nxënësve Përveç ndërhijëve të nivelit 2, merrni parasysh: • Mbështetje individuale nga psikologët/këshilluesit e shkollës • Lidhja me shërbimet e jashtme mbështetëse, përfshirë shërbimet shëndetësore • Puna e ngushtë me prindërit • Plani i mbështetjes së nxënësve, në bashkëpunim me agjenci të jashtme

Tabela 7: Qasja me tre nivele për parandalimin e braktisjes

ANEKS 1. ANKETA E KONTROLLIT TË MIRËQENIES

Anketa e Kontrollit të Mirëqenies së Shkollës përbëhet nga disa pohime. Merrni parasysh se çfarë përparësie i jep shkolla juaj secilës prej praktikave të përshkruara në pohime. Shembujt e dhënë janë vetëm një udhëzues.

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

I mësoni nxënësve në mënyrë të qartë aftësitë sociale dhe emocionale duke përdorur praktika të bazuara në dëshmi që lidhen me sigurinë personale, qëndrueshmërinë, kërkimin e ndihmës dhe sjelljet mbrojtëse në të gjithë kurrikulën.

(Mësuesit e mi më kanë mësuar se si të menaxhoj emocionet e mia dhe se të kërkosh ndihmë është një shenjë force. - Nxënës)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Kërkoni në mënyrë aktive përfshirjen e të gjithë komunitetit të shkollës në njohjen dhe promovimin e sjelljes pozitive.

(Ftojme të gjithë në shkollën tonë që të përfshihen aktivisht në demonstrimin dhe promovimin e vlerave tona. Nga stafi i shkollës dhe grupet e drejtuara nga nxënësit - ne zotërojmë dhe modelojmë sjellje pozitive. - Drejtor)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Përdorni analizën kritike dhe vlerësimin e të dhënave të shkollës për të informuar vendimmarrjen në mënyrë që t'i përgjigjeni në mënyrë efektive nevojave në ndryshim të nxënësve dhe familjeve.

(Ne mbledhim rregullisht të dhëna dhe angazhohemi drejtpërdrejt me prindërit dhe familjet për të adresuar nevojat specifike të një nxënësi dhe për të mbështetur rezultatet e tyre të suksesshme të të mësuarit dhe mirëqenies. - Anëtar i ekipit të SPH)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Respektoni diversitetin e komunitetit të shkollës dhe zbatoni strategji për të ndërtuar një shkollë kohezive dhe të sigurt.

(Në shkollën time ndihem i kuptuar dhe bashkë me mësuesit punojmë në grupet tona të klasës për t'i bërë të gjithë, pavarësisht nga prejardhja e tyre, të ndiejnë përkatësi. - Nxënës)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Ndërtoni lidhje me organizatat, shërbimet dhe agjencitë e komunitetit për të identifikuar nevojat dhe për të planifikuar në mënyrë bashkëpunuese mbështetjen e synuar për të gjithë nxënësit dhe familjet, duke përfshirë ato nga grupet e cënueshme.

(Ne promovojmë një përgjegjësi kolektive në mbarë shkollën për të mësuarit dhe mirëqenien, e cila ndahet në të gjithë komunitetin e shkollës. - Anëtar i ekipit drejtues)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Zhvilloni dhe mbani marrëdhënie të respektueshme me familjet dhe komunitetet përmes strategjive që janë mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse.

(Shkolla jonë vërtet vlerëson komunitetin tonë dhe planifikon rregullisht takime. - Anëtar i ekipit drejtues)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Ndërtoni kapacitetin e nxënësve nëpërmjet të mësuarit profesional për të përmirësuar rezultatet akademike, sociale, emocionale dhe për të promovuar mirëqenien e stafit.

(Kam mësuar shumë për lidhjet midis mirëqenies dhe të mësuarit – nuk mund të kesh njërin pa tjetrën. Me të vërtetë ka ndryshuar praktikën time profesionale. - Mësuese e AFP)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Rritni dhe mbështetni të mësuarit e nxënësve dhe mirëqenien e të gjithë komunitetit të shkollës përmes zhvillimit të vizionit dhe vlerave të shkollës.

(Ekipi ynë drejtues fillon çdo vit duke rishikuar vizionin dhe vlerat e shkollës sonë në mënyrë që çdo anëtar i komunitetit tonë t'i kuptojë dhe t'i zbatojë ato në praktikë. - Drejtor)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

I jepni nxënësve mundësi për vendimmarrje të drejtpërdrejtë mbi çështjet që i prekin ata.

(Në shkollën time, ne kemi përfaqësues të nxënësve në të gjitha grupet drejtuese të shkollës. - Nxënësi)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Zbatoni një qasje sistematike të shkollës për mirëqenien dhe sjelljen pozitive me nivele të mbështetjes për të përmbushur nevojat e ndryshme të stafit, nxënësve dhe familjeve.

(Asnjë nxënës apo familje nuk ka të njëjtat nevoja, kështu që shkolla jonë fillon nga një kuptim kolektiv i lidhjes midis mirëqenies dhe të mësuarit dhe më pas zhvillon mbështetjen e personalizuar të nevojshme për çdo nxënës për të arritur potencialin e tij. - Zëvendësdrejtor)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Angazhoni në mënyrë aktive nxënësit në mënyra për të përmirësuar të nxënit dhe mirëqenien e tyre përmes përdorimit të qasjeve të bazuara në pikat e forta, nga të dhënat e shkollës.

(Falë mësuesve të mi, unë e di modelin tim të të mësuarit dhe se si të përdor pikat e mia të forta për të arritur qëllimet që i vendos vetes. - Nxënës)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Kërkoni dhe pranoni në mënyrë aktive pikëpamjet e nxënësve për sigurinë dhe mirëqenien në mënyrë që të promovoni rezultate pozitive të të nxënit.

(Shkolla jonë ka zhvilluar një sërë mënyrash për të përfshirë nxënësit në politikat e sigurisë dhe mirëqenies ... ne jemi të gjithë së bashku dhe pjesëmarrja e tyre ka rëndësi. - Mësues)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

I mësoni, modeloni dhe promovoni nxënësve vlera dhe sjellje të qarta pro-sociale në mënyrë që të krijojnë dhe mbani një mjedis mësimor mbështetës dhe të sigurt.

(Ne e dimë ndikimin e modelimit të sjelljes pozitive. Ne kemi një përgjegjësi të madhe – nxënësit duhet të shohin vlerat tona në veprim tek çdo gjë që bëjmë. - Mësues)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Ndërtoni partneritete bashkëpunuese me familjet dhe komunitetet për të siguruar një kuptim të përbashkët të mësimi, sigurisë dhe mirëqenies së nxënësve.

(Ne kemi shumë mënyra për të përfshirë familjet dhe komunitetet – nga takimet informuese të prindërve, ditën e gjyshërve, këshilli dhe komitetet e shkollës, madje edhe ekskursionet shkollë! Ne nuk do të kishim mjedisin tonë të sigurt dhe pozitiv të të mësuarit pa ndihmën e tyre. - Drejtor)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

- **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Krijoni mjedise mësimore përfshirëse dhe ndërvepruese për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë dhe lidhjes me shkollën.

(Mësuesi im ndan role në grup për t'u siguruar që ne të mësojmë se si të dëgjojmë, kontribuojmë dhe punojmë së bashku në mënyrë efektive. - Nxënës)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

• **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Nxitni dhe mbani marrëdhënie të kujdesshme dhe të respektueshme nxënës-nxënës, mësues- nxënës, mësues-prindër dhe mësues-mësues.

(Respekti është guri i themelit - nuk është gjithmonë e lehtë të rrisësh një adoleshent, por mësuesit ndihmojnë dhe më pëlqen që ne mund të punojmë së bashku për të ndërtuar marrëdhënie respekti. - Prind)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

• **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Njihni dhe vlerësoni rolin dhe kontributin e stafit, nxënësve dhe familjeve në ndërtimin dhe ruajtjen e lidhjes me shkollën.

(Në fillim të çdo viti, unë drejtoj një seminar me stafin, prindërit dhe nxënësit për të vendosur prioritetet dhe synimet tona për të siguruar që çdo nxënës të respektohet dhe vlerësohet – kjo bëhet e gjithë politika e shkollës sonë. - Drejtor)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

• **Çfarë prioriteti i jep shkolla juaj praktikës së mëposhtme?**

Në bashkëpunim me nxënësit, zhvilloni strategji për rritjen e mirëqenies, promovimin e sigurisë dhe luftimin e dhunës, bullizmit dhe abuzimit në të gjitha hapësirat fizike dhe online.

(Ne ndihmuam në zhvillimin e politikës së shkollës për sigurinë kibernetike – shkolla e vlerësoi vërtet kontributin tonë dhe këshilli i nxënësve e zotëron plotësisht atë. - Nxënës)

Zgjidhni vlerësimin e përparësisë më poshtë:

Shumë e ulët / E ulët / E mesme / E lartë / Shumë e lartë

Reflektim

1. Si e trajtoni mirëqenien e nxënësve në klasën tuaj? Listoni 10 aktivitete.
2. Si e mbështet shkolla juaj mirëqenien e nxënësve më të pa favorizuar dhe në rrezik, duke përfshirë rrezikun e braktisjes?
3. Në një shkallë nga 1 deri në 10, sa mendoni se punon shkolla në mbështetjen e mirëqenies së nxënësve më të pa favorizuar dhe nxënësve në rrezik, duke përfshirë ata që rrezikojnë të braktisin shkollën?

Burime shtesë

Vlerësimi i mirëqenies, shkallët dhe auditimi i shkollës për mbështetjen e mirëqenies

- Njësia e Praktikave të Bazuara në Dëshmi, UCL, Qendra Kombëtare e Anna Freud për Fëmijët dhe Familjet (2021) [Child Outcomes Research Consortium In partnership with Wellbeing Measurement Framework for Primary Schools](#).
- Mentally Healthy Schools UK (2020) [Strengths and Difficulties Questionnaire](#)
- <http://www.socialworkerstoolbox.com/the-adolescentt-wellbeing-scale/>
- <https://www.samh.org.uk/about-mental-health/self-help-and-wellbeing/wellbeing-assessment-tool>
- <https://www.corc.uk.net/outcome-experience-measures/student-resilience-survey/>

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin tuaj të shkollës me Detyrën 2.

MJETI 7. TË NXËNIT SOCIO-EMOCIONAL

Kuptimi

Të nxënës socio-emocional është i rëndësishëm për të gjithë nxënësit, dhe veçanërisht kritik për ata në rrezik të braktisjes. Mbështetja e të nxënës socio-emocional është një pjesë kyçe e një qasjeje holistike për mirëqenien e nxënësve dhe për parandalimin e braktisjes.

“Është procesi përmes të cilit të gjithë të rinjtë dhe të rriturit fitojnë dhe zbatojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet për të zhvilluar identitete të shëndetshme, për të menaxhuar emocionet dhe për të arritur qëllimet personale dhe kolektive, për të ndjerë dhe treguar empati për të tjerët, për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mbështetëse dhe për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të kujdesshme.” (Bashkëpunimi për të mësuarin akademik, social dhe emocional, <https://casel.org/fundamentals-of-sel/>).

Ekzistojnë disa korniza të të nxënës socio-emocional, duke përfshirë:

- **Korniza e Bashkimit Evropian:** bazuar në punën e Sala et al., 2020: [The LifeComp: European Framework for Personal, Social and Learning to Learn Key Competence](#)
- **Korniza Amerikane nga CASEL** - Bashkëpunimi për të mësuarit Akademik, Social dhe Emocional (CASEL), <https://casel.org/>
- **Korniza e OECD**, bazuar në studimin mbi aftësitë sociale dhe emocionale nga Chernyshenko et al., 2018. Shihni [Social and Emotional Skills: Well-being, connectedness and success](#).

Shembuj të kornizave

Korniza CASEL

Kompetenca	Përshkrimi
Vetë-ndërgjegjësimi (intrapersonale)	Aftësia për të njohur me saktësi emocionet, mendimet dhe vlerat dhe se si ato ndikojnë në sjellje. Aftësia për të vlerësuar me saktësi pikat e forta dhe të dobëta, me një ndjenjë të mirë besimi në vete, optimizmi dhe një 'mendësi zhvillimi/rritje'. • Identifikimi i emocioneve • Perceptimi i saktë i vetes • Njohja e pikave të forta/të dobëta • Vetëbesimi • Vetë-efikasiteti
Vetë-menaxhimi (intrapersonale)	Aftësia për të rregulluar me sukses emocionet, mendimet dhe sjelljet në situata të ndryshme - menaxhimin efektiv të stresit, kontrollin e impulseve dhe motivimin e vetvetes. Aftësia për të vendosur dhe punuar drejt qëllimeve personale dhe akademike. • Kontrolli i impulsit • Menaxhimi i stresit • Vetëdisiplina • Motivimi i brendshëm • Vendosja e qëllimeve • Aftësitë organizative

Kompetenca	Përshkrimi
Ndërgjegjësimi social (interpersonale)	Aftësia për të marrë këndvështrime të tjera dhe për të qenë empatik, duke përfshirë ata me prejardhje dhe kultura të ndryshme. Aftësia për të kuptuar normat sociale dhe etike për sjelljen, për të njohur burimet e mbështetjes së familjes, shkollës dhe komunitetit. • Marrja e perspektivave • Empatia • Vlerësimi i diversitetit • Respekti për të tjerët
Aftësitë e marrëdhënieve (interpersonale)	Aftësia për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie të shëndetshme dhe shpërblyese me individë dhe grupe të ndryshme. Aftësia për të komunikuar qartë, për të dëgjuar mirë, për të bashkëpunuar me të tjerët, për t'i rezistuar presionit të papërshtatshëm shoqëror, për të negociuar konfliktin në mënyrë konstruktive dhe për të kërkuar dhe ofruar ndihmë kur është e nevojshme. • Komunikimi • Angazhimi social • Ndërtimi i marrëdhënieve • Puna në grup
Vendimmarrja me përgjegjësi (konjitive)	Aftësia për të bërë zgjedhje konstruktive në lidhje me sjelljen personale dhe ndërveprimet sociale bazuar në standardet etike, shqetësimet për sigurinë dhe normat sociale. Vlerësimi real i pasojave të veprimeve të ndryshme dhe konsiderimi i mirëqenies së vetes dhe të tjerëve. • Identifikimi i problemeve • Analizimi i situatave • Zgjidhja e problemeve • Vlerësimi • Reflektimi • Përgjegjësia etike

Tabela 8: Korniza e aftësive socio-emocionale (CASEL)

Burimi: Bashkëpunimi për të mësuarit Akademik, Social dhe Emocional (CASEL), <https://casel.org/>

Korniza e Bashkimit Evropian

Fusha	Kompetenca	Përshkrimi		
PERSONALE	P1. Vetë-rregullimi (Ndërgjegjësimi dhe menaxhimi i emocioneve, mendimeve dhe sjelljeve)	P1.1 Ndërgjegjësimi dhe shprehja e emocioneve, mendimeve, vlerave dhe sjelljes personale	P1.2 Kuptimi dhe rregullimi i emocioneve, mendimeve dhe sjelljes personale, duke përfshirë përgjigjet ndaj stresit	P1.3 Mbajtja e optimizmit, shpresës, reziliencës, vetë-efikasitetit dhe ndjenjës e të paturit qëllim për të mbështetur të mësuarit dhe vepruarit
	P2. Fleksibiliteti (Aftësia për të menaxhuar tranzicionet, pasigurinë dhe për të përballuar sfidat)	P2.1 Gatishmëria për të rishikuar opinionet dhe rrjedhat e veprimit përballë evidencave të reja	P2.2 Kuptimi dhe adoptimi i ideve, qasjeve, mjeteve dhe veprimeve të reja në përgjigje të konteksteve në ndryshim	P2.3 Menaxhimi i tranzicioneve në jetën personale, pjesëmarrjen sociale, drejtimit e punës dhe të të mësuarit, duke bërë zgjedhje të vetëdijshme dhe duke vendosur qëllime
	P3. Mirëqenia (Kërkimi i kënaqësisë nga jeta, kujdesi për shëndetin fizik, mendor dhe social; dhe adoptimi i një stili jetese të qëndrueshëm)	P3.1 Ndërgjegjësimi se sjellja individuale, karakteristikat personale dhe faktorët social dhe mjedisor ndikojnë tek shëndeti dhe mirëqenia	P3.2 Kuptimi i rreziqeve të mundshme për mirëqenien dhe përdorimi i informacionit dhe shërbimeve të besueshme për shëndetin dhe mbrojtjen sociale	P3.3 Adoptimi i një stili jetese të qëndrueshëm që respekton mjedisin dhe mirëqenien fizike dhe mendore të vetes dhe të tjerëve, duke kërkuar dhe ofruar mbështetje sociale
SOCIALE	S1. Empatia (Kuptimi i emocioneve, përvojave dhe vlerave të një)	S1.1 Ndërgjegjësimi për emocionet, përvojat dhe	S1.2 Kuptimi i emocioneve dhe përvojave të një personi tjetër dhe	S1.3 Përgjegjshmëria ndaj emocioneve dhe përvojave

Fusha	Kompetenca	Përshkrimi		
	personi tjetër dhe ofrimi i përgjigjeve të duhura)	vlerat e një personi tjetër	aftësia për të pranuar në mënyrë proaktive perspektivën e tyre	të një personi tjetër, duke qenë i vetëdijshëm se përkatësia në grup ndikon në qëndrimin e dikujt
	S2. Komunikimi (Përdorimi i strategjive të komunikimit, në varësi të kontekstit dhe përmbajtjes)	S2.1 Ndërgjegjësimi për nevojën e një shumëllojshmërie strategjish komunikimi, regjistrash gjuhësorë dhe mjeteve që përshtaten me kontekstin dhe përmbajtjen	S2.2 Kuptimi dhe menaxhimi i ndërveprimeve dhe bisedave në kontekste të ndryshme socio-kulturore dhe situata specifike të fushës	S2.3 Dëgjimi i të tjerëve dhe përfshirja në biseda me vetëbesim, këmbëngulje, qartësi dhe reciprocitet, si në kontekste personale ashtu edhe sociale
	S3. Bashkëpunimi (Angazhimi në aktivitete në grup dhe punë në ekip duke pranuar dhe respektuar të tjerët)	S3.1 Synimi për të kontribuar për të mirën e përbashkët dhe ndërgjegjësimin se të tjerët mund të kenë përkatësi të ndryshme kulturore, prejardhje, besime, vlera, opinione ose rrethana personale	S3.2 Të kuptuarit e rëndësisë së besimit, respektit për dinjitetin dhe barazinë njerëzore, përballimin e konflikteve dhe negocimin e mosmarrëveshjeve për të ndërtuar dhe mbajtur marrëdhënie me respekt	S3.3 Ndarja e drejtë e detyrave, burimeve dhe përgjegjësi brenda një grupi duke marrë parasysh qëllimin specifik, nxitja e të shprehurit të pikëpamjeve të ndryshme dhe adoptimi i një qasjeje sistematike
TË MËSUARIT PËR TË MËSUAR	L1. Mendësia e rritjes (Besimi në vete dhe të tjerët, potenciali për të mësuar dhe përparuar vazhdimisht)	L1.1 Ndërgjegjësimi dhe besimi në aftësitë personale dhe të të tjerëve për të mësuar, përmirësuar dhe arritur lart me	L1.2 Të kuptuarit se të mësuarit është një proces i përjetshëm që kërkon përshtatje, kuriozitet dhe vendosmëri	L1.3 Reflektimi mbi komentet e njerëzve të tjerë, si dhe mbi përvojat e suksesshme dhe të pasuksesshme për të vazhduar

Fusha	Kompetenca	Përshkrimi		
		punë dhe përkushtim		zhvillimin e potencialit
	L2. Të menduarit kritik (Vlerësimi i informacionit dhe argumenteve për të mbështetur përfundimet e arsyetuara dhe për të zhvilluar zgjidhje novatore)	L2.1 Ndërgjegjësimi për paragjykimet e mundshme në të dhënat dhe kufizimet personale, mbledhja e informacionit dhe ideve të vlefshme dhe të besueshme nga burime të ndryshme me reputacion	L2.2 Krahasimi, analizimi, vlerësimi dhe sintetizimi i të dhënave, informacionit, ideve dhe mesazheve mediatike për të nxjerrë përfundime logjike	L2.3 Zhvillimi i ideve krijuese, sintetizimi dhe kombinimi i koncepteve dhe informacionit nga burime të ndryshme në funksion të zgjidhjes së problemeve
	L3. Menaxhimi i të nxënës (Planifikimi, organizimi, monitorimi dhe rishikimi i të nxënës personal)	L3.1 Ndërgjegjësimi për interesat, proceset dhe strategjitë e preferuara të të mësuarit, duke përfshirë nevojat e të mësuarit dhe mbështetjen e kërkuar	L3.2 Planifikimi dhe zbatimi i qëllimeve, strategjive, burimeve dhe proceseve të të mësuarit	L3.3 Reflektimi dhe vlerësimi i qëllimeve, proceseve dhe rezultateve të të mësuarit dhe ndërtimit të njohurive, vendosja e marrëdhënieve në fusha

Tabela 1: Korniza e Bashkimit Evropian

Burimi: Sala, A., Punie, Y., Garkov, V. dhe Cabrera Giraldez, M., LifeComp: [The European Framework for Personal, Social and Learning to Learn Key Competence](#), EUR 30246 EN, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2020, ISBN 978-92-76-19418-7, doi:10.2760/302967, JRC120911

Përfshirja e të nxënës socio-emocional në shkolla

Të nxënës socio-emocional mund të ndodhë përmes mësimdhënies së rregullt lëndore dhe përmes mësimdhënies specifike socio-emocionale (si lëndë, si klub, si aktivitete të njëpasnjëshme që ndërtojnë kompetenca specifike - si menaxhimi i stresit, të menduarit kritik, etj.)

Sfidat në klasat 10 dhe 11

Nxënësit fokusohen gjithnjë e më shumë tek vetja teksa kërkojnë të zhvillojnë një identitet koherent. Ata fillojnë të reflektojnë mbi vlerat dhe normat me të cilat janë rritur, ndërsa vazhdojnë të zhvillojnë identitetet dhe qëllimet e tyre në jetë. Në disa raste, ata mund të vënë në dyshim, madje edhe të refuzojnë, vlerat që kanë mësuar në shtëpi ose në shkollë. Ky lloj rebelimi i adoleshentëve është një fazë relativisht e zakonshme, megjithëse mund të jetë shumë e vështirë për prindërit dhe mësuesit që

ta kuptojnë dhe ta pranojnë. Megjithatë, është e rëndësishme të pranohet se kjo është një pjesë e natyrshme e rritjes.

Së bashku me këtë vetëdije dhe vetë-zbulim më të madh vijjnë luhatjet në rritje në vetëvlerësimin dhe paqëndrueshmërinë emocionale të adoleshentëve. Ndonjëherë ata duket se kanë një vetëvlerësim shumë të lartë dhe një ego të fryrë dhe ndjenjë unike, ndërsa në të tjera duket se ndihen keq me veten dhe kalojnë nëpër faza të shpeshta të vetëkritikës, trishtimit dhe zemërimit. Intensiteti i ngritjeve dhe uljeve të tyre emocionale është i lidhur me ndryshimet hormonale që ndodhin gjatë pubertetit dhe aftësinë e tyre në rritje për të reflektuar mbi proceset e tyre të menduarit.

Roli i mësuesit

Puna e mësuesit në klasat 10 dhe 11 synon t'i ndihmojë ata të kuptojnë veten, të mësojnë dhe praktikojnë strategji që rrisin vetëkontrollin e tyre dhe të kuptojnë rreziqet dhe pasojat e përfshirjes në sjellje me rrezik të lartë.

Sfidat në klasën e 12-të

Në kohën kur arrijnë klasën e 12-të, adoleshentët po përgatiten për kalimin në moshën madhore. Kjo do të thotë se ata po zhvillojnë një grup të qëndrueshëm vlerash dhe besimesh që do të ndihmojnë në orientimin e tyre në të ardhmen. Ndërsa i afrohen moshës tetëmbëdhjetë vjeç, ata janë më në gjendje të përshkruajnë dhe diskutojnë sistemin e tyre personal të vlerave, i cili mund të përfshijë vlera fetare, kulturore, politike dhe familjare.

Adoleshentët po shqetësohen më pak për atë që mendojnë shokët e klasës dhe po shqetësohen më shumë për të kuptuar vlerat e tyre. Ata janë më të aftë për të menduar dhe reflektuar për veten dhe të ardhmen e tyre. Ndryshimet hormonale dhe të humorit fillojnë të stabilizohen gjatë kësaj periudhe, me ngritje dhe ulje ekstreme që zakonisht zvogëlohen ose zhduken plotësisht. Adoleshentët janë të përfshirë në mënyrë aktive në marrëdhënie romantike që zgjasin më shumë sesa gjatë adoleshencës së hershme ose të mesme. Ata gjithashtu kanë filluar të mendojnë për krijimin e familjeve të tyre dhe në përgjithësi kanë fantazi për personin me të cilin do të martohen, sa fëmijë do të kenë dhe si do të jetë jeta e tyre si të rritur. Edhe pse përballen me situata dhe vendime sikur të ishin të rritur, truri i tyre ende nuk është pjekur plotësisht dhe vazhdojnë të kenë probleme me vetëkontrollin dhe impulsivitetin. Nuk është e pazakontë që ata të marrin vendime pa marrë parasysh me kujdes pasojat ose që ata të jetojnë jetën e tyre duke menduar më shumë për të tashmen sesa për të ardhmen.

Roli i mësuesit

Detyra e mësuesit në klasën e 12-të është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë veten dhe të ardhmen e tyre. Shumë nga vendimet që ata do të fillojnë të marrin në këtë moment në kohë (të tilla si lloji i punës që ata aspirojnë të kenë) mund të ndikojnë potencialisht në pjesën tjetër të jetës së tyre.

Mendësia e Rritjes

MENDËSIA E RITJES MUND TË MËSOHET!!!	Lavdërimi i Përpjekjeve dhe Procesit mbi Rezultatet “Uau, ia dole shumë mirë. Duhet të kesh punuar vërtet shumë.” “Më trego për mënyrat e ndryshme që ke përdorur për të arritur tek ajo përgjigje.”
	Zhvillimi i një Kulture që Toleron Rrezikun “Ne vlerësojmë më shumë përballimin e sfidave të vështira sesa suksesin e lehtë.”
	Theksi tek Prosesi dhe Këmbëngulja Në vend që të shfaqni vetëm punët e përfunduara të nxënësve, vlerësoni punën në vazhdim, në mënyrë që nxënësit të mund të shohin se si puna zhvillohet me përpjekje dhe mësim të reja.
	Mendimi për Trurin si diçka që Rritet Punoni me nxënësit tuaj për të krijuar postera se si truri, ashtu si një muskul, rritet dhe forcohet me përpjekje.
	Inkurajimi i Nxënësve për të ndarë Këshilla Kërkojuni nxënësve të shkruajnë letra duke i dhënë këshilla një nxënësi në vështirësi, i cili nuk mendon se është mjaft i mirë për të patur sukses.
	Kornizimi i Gabimeve si Pjesë e Procesit të të Mësuarit Kur prezantoni materialin e ri, thoni diçka si: “Pasi të përfundojmë këtë mësim, unë do t'ju kërkoj secilit prej jush të tregojë një gabim që keni bërë gjatë kryerjes së detyrave tuaja, sepse gabimet na ndihmojnë të mësojmë”.
	Shpërblimi i Përpjekjeve të Procesit Krijoni një rubrikë vlerësimi që fokusohet në përpjekje ose proces, përveç asaj që fokusohet në rezultate.
	Komunikimi i Pritshmërive të Larta Si pjesë e komenteve me shkrim për nxënësit (veçanërisht ata që nuk kanë performancë të ulët) komunikoni në mënyrë eksplicite pritshmëri të larta: 'Po ju jap këto komente sepse e di që ju mund t'i përmbushni ato.'

Reflektim

1. Në çfarë mase po jepni mësim mbi të nxënësit socio-emocional në klasën/shkollën tuaj?
2. Cilat janë pengesat për të futur të nxënësit socio-emocional në mësimdhënien/klasën/shkollën tuaj?
3. Çfarë do t'ju duhej, si profesionist, për të mbështetur më mirë nxënësit në rrezik të braktisjes dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre socio-emocionale?

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin e shkollës suaj me Detyrën 3.

MJETI 8. PËRBALLJA ME ANKTHIN DHE STRESIN

Kuptimi i stresit

Ankthi është një ndjenjë shqetësimi, pasigurie, ose frike. Mund të jetë i lehtë ose i rëndë dhe ndikon në mënyrën se si mendojmë e sillemi dhe në aftësinë tonë për t'u përqendruar, çlodhur dhe bashkëvepruar me të tjerët.

Stresi është një përgjigje biologjike ndaj kërcënimit dhe rrezikut. Kur ekspozohet ndaj rrezikut ose kërcënimit, truri lëshon hormone që i mundësojnë trupit të përgatitet për një përgjigje 'lufto ose ik'. Kjo i mundëson trupit tonë të marrë më shumë oksigjen dhe të pompojë gjak më shpejt në muskuj, në mënyrë që të vrapojmë më shpejt ose të luftojmë më mirë. Ne gjithashtu bëhemi më vigjilentë dhe shqisat tona mprehen.

Stresi zakonisht ndodh kur ka një **mospërputhje midis kërkesave të perceptuara dhe aftësisë së perceptuar për të përballuar**. Manifestohet ndryshe për njerëz të ndryshëm. Mund të na ndikojë fizikisht (duart e djersitura, rrahje zemre, dhimbje stomaku, diarre) dhe mund të çojë në humbje të gjumit ose oreksit, acarim, humor të ulët dhe përqendrim të dobët.

Kërcënimet nuk janë vetëm fizike. Në një kontekst arsimor, të kuptuarit se jemi vonë për në shkollë, pyetjet e një mësuesi, diskutimet para klasës, një takim me drejtorin e shkollës, testet dhe provimet mund të shkaktojnë një përgjigje stresi. Edhe pse stresi është i natyrshëm dhe i shëndetshëm, ai gjithashtu mund të bëhet problem.

Për shkak se adoleshentët kanë më pak përvojë të faktorëve stresues, ata mund të jenë më pak në gjendje të përpunojnë ngjarje të reja dhe kanë më pak gjasa të kenë strategji të disponueshme për t'u përballur me stresin. Ata janë gjithashtu të zënë me shkollën, miqtë, ekranet dhe mediat sociale, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për t'u çlodhur.

MJETI 9. PARANDALIMI I DISKRIMINIMIT DHE BULLIZMIT

Diskriminimi është një nga faktorët që ndikon në procesin e braktisjes. Diskriminimi dhe përvoja e diskriminimit mund të rrjedhin nga faktorë të shumtë të ndërlidhur, duke përfshirë përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, gjininë, moshën dhe sfondin socio-ekonomik.

Diskriminimi është një trajtim i padrejtë, ose paragjykes i kategorive të ndryshme të njerëzve, shpesh për shkak të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, etj. Diskriminimi mund të marrë formën e agresionit fizik ose verbal dhe qëndrimeve negative ose të jetë sistematik dhe i përforcuar përmes legjislacionit dhe proceseve të tjera (p.sh., nxënësit nga pakicat etnike që thirren me epitete nga bashkëmoshatarët ose mësuesit në shkollë; refuzimi për të regjistruar një nxënës bazuar në përkatësinë etnike; legjislacioni që ndalon në mënyrë eksplicite emigrantët e paligjshëm ose fëmijët pa shtetësi të regjistrohen në shkollë).

Bullizmi është sjellje e një individi ose grupi, e përsëritur me kalimin e kohës, që me dashje lëndon një individ ose grup tjetër fizikisht ose emocionalisht. Bullizmi merr shumë forma, duke përfshirë bullizmin kibernetik, dhe shpesh motivohet nga paragjykimi ndaj grupeve të veçanta, për shembull, në bazë të racës, fesë, gjinisë, nevojave të veçanta arsimore ose aftësive të kufizuara.

Shkollat kanë për detyrë të sigurojnë që asnjë grup të mos diskriminohet dhe se sfidojnë çdo pabarazi dhe stereotip që hasin nxënësit.

Nga perspektiva e qasjes së të gjithë shkollës, diskriminimi dhe parandalimi i bullizmit duhet të trajtohen në nivel të shkollës, stafit dhe nxënësve. Parandalimi efektiv i bullizmit shkon përtej trajnimit të mësuesve dhe mësimdhënies për bullizmin në klasë dhe kërkon një ndryshim në klimën e shkollës dhe krijimin e një sjelljeje të mirë të bazuar në respekt.

Përveç politikave, procedurave dhe trajnimit të mësuesve, të nxënësve socio-emocional luan një rol të madh në parandalimin e diskriminimit dhe bullizmit duke i mbështetur nxënësit të zhvillojnë aftësi kyçe si:

- Menaxhimi i emocioneve
- Empatia
- Vlerësimi i diversitetit
- Respekti për të tjerët
- Marrja e perspektivave
- Komunikimi dhe negocimi
- Ndërtimi i marrëdhënieve
- Ndërtimi i ekipit

Këto aftësi mund t'i ndihmojnë nxënësit në një sërë situatash: (i) kur ata bullizohen, duke i ndihmuar ata të bëhen më të sigurt, të menaxhojnë emocionet e tyre dhe të krijojnë miqësi, të cilat janë faktorë kryesorë mbrojtës nga bullizmi, (ii) kur ata janë autorë të bullizmit, duke i ndihmuar ata të ndryshojnë këndvështrimin, dhe (iii) kur ata janë dëshmitarë të bullizmit (kalimtarët e rastit), duke përforcuar mundësitë për të kapërcyer apatinë si kalimtar dhe për të ndërhyrë.

Bullizmi kërkon ndërhyrje mbështetëse që adresojnë nevojat socio-emocionale si të bullizuesit ashtu edhe të të bullizuarit.

Aktivitete për t'i mësuar nxënësit rreth bullizmit

Shkollat nuk kanë gjithmonë nevojë për programe formale për t'i ndihmuar nxënësit të mësojnë rreth parandalimit të bullizmit. Shkollat mund të përfshijnë temën e parandalimit të bullizmit në mësimet dhe aktivitete. Shembuj të aktiviteteve për të mësuar rreth bullizmit përfshijnë:

- Hulumtimi në internet ose bibliotekë, të tilla si kërkimi i llojeve të bullizmit, si ta parandaloni atë dhe si duhet të reagojnë nxënësit
- Prezantime, të tilla si një fjalim ose lojë me role për të ndaluar bullizmin
- Diskutimet rreth temave si raportimi i bullizmit
- Shkrimi kreativ, si p.sh. një poezi që flet kundër bullizmit ose një histori ose skemë që u mëson atyre që nuk janë të përfshirë direkt se si të ndihmojnë
- Punime artistike, të tilla si një kolazh për respektin ose efektet e bullizmit
- Takime në klasë për të folur për marrëdhëniet me bashkëmoshatarët

Çfarë bëjnë shkollat e suksesshme?

- Përfshijnë prindërit për t'u siguruar që ata të jenë të qartë se shkolla nuk e toleron bullizmin dhe janë të vetëdijshëm për procedurat që duhen ndjekur nëse besojnë se fëmija i tyre është bullizuar. Prindërit ndihen të sigurt se shkolla do të pranojë çdo ankesë për bullizmin dhe ta zgjidhin çështjen në një mënyrë që mbron fëmijën dhe përforcojnë vlerat e sjelljes së mirë;

- Përfshijnë nxënësit. Të gjithë nxënësit e kuptojnë qasjen e shkollës dhe e kanë të qartë pjesën që ata mund të luajnë për të parandaluar bullizmin, duke përfshirë kur e gjejnë veten si kalimtarë të rastit;
- Zbatojnë sanksione disiplinore. Pasojat e bullizmit reflektojnë seriozitetin e incidentit në mënyrë që të tjerët të shohin se bullizmi është i papranueshëm;
- Diskutojnë hapur dallimet mes njerëzve, që mund të motivojnë bullizmin, si p.sh. dallimet në lidhje me fenë, përkatësinë etnike, paaftësinë, gjininë, seksualitetin ose pamjen, gjithashtu fëmijët me situata të vështira familjare.
- Shkollat mund të investojnë në aftësimin e specializuar për të ndihmuar stafin e tyre të kuptojë nevojat e nxënësve të tyre, duke përfshirë ata me nevoja të veçanta arsimore dhe/ose paaftësi, etj.
- I lehtësojnë nxënësve raportimin e bullizmit në mënyrë që ata të sigurohen se do të dëgjohen dhe shkolla do të veprojnë mbi incidentet. Shkollat duhet të krijojnë një mjedis të sigurt ku nxënësit mund të diskutojnë hapur shkakun e ngacmimit të tyre, pa frikë nga bullizmi i mëtejshëm ose diskriminimi.

Burimet kryesore për bullizmin në shkollë:

- Downes P.; Cefai, C., [How to Prevent and Tackle Bullying and School Violence: Evidence and Practices for Strategies for Inclusive and Safe Schools](#), Raporti NESET II, Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2016.
- https://ec.europa.eu/justice/grants/results/daphne-toolkit/content/peer-support-and-youth-participation-bullying-prevention_en#

MJETI 10. MENAXHIMI I TË MËSUARIT DHE TË MËSUARIT PËR TË MËSUAR

Ka një sërë aftësish që mbështesin nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, të cilat mund të emërtohen dhe klasifikohen në mënyra të ndryshme në varësi të kornizave që përdorim. Këto aftësi përfshijnë si botëkuptimin, ashtu edhe aftësitë e menaxhimit të të mësuarit. Ato përfshijnë aftësi që lidhen me:

- **Vetë-menaxhimi**, i cili i referohet aftësive organizative si menaxhimi i kohës, vetëdisiplinimi, menaxhimi i stresit dhe vendosja e qëllimeve;
- **Vetë-efikasiteti**, i cili ka të bëjë me besimin e njerëzve për aftësinë e tyre për të ekzekutuar një veprim; dhe
- **Vetërregullimi**, i cili përfshin proceset mendore të të kuptuarit dhe të nxënës (konjicioni), metakonjicionin (aftësia për të planifikuar, monitoruar, vlerësuar dhe ndryshuar sjelljet e të nxënës) dhe motivimin.

Aftësitë	Përshkrimi	Aktivitetet
Vetë-menaxhimi	Aftësi organizative si menaxhimi i kohës, vetë-disiplina, menaxhimi i stresit dhe vendosja e qëllimeve	• Të gjeni se kur është koha më e mirë për të studiuar • Rutina e studimit (përgatitja e detyrave, etj.) • Të kuptojnë se kur nxënësit përqendrohen më mirë dhe çfarë i largon ata nga të mësuarit (telefonat, etj.) • Përcaktimi i një objektivi për çdo periudhë studimi • Zbërthimi i detyrave mësimore në detyra të vogla • Organizimi i ngarkesës së punës për ditën/javën • Planifikimi i detyrave të shtëpisë dhe projekteve
Vetë-efikasiteti	Besimi i njerëzve në aftësitë e tyre për të kryer një veprim	• Ndërtimi i besimit duke filluar me detyra të vogla • Përdorimi i metodave të të mësuarit me shkallë • Modelimi i bashkëmoshatarëve • Të mësosh nga sukseset dhe dështimet e të tjerëve • Mësimi i vetë-verbalizimit • Kujtimi i përvojave të mëparshme Mësuesit të demonstrojnë pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit dhe besim në kapacitetet dhe suksesin e tyre.
Vetërregullimi	Përfshin proceset mendore të të kuptuarit dhe të nxënës (konjicioni), metakonjicionin (aftësia për të planifikuar, monitoruar, vlerësuar dhe ndryshuar sjelljet	• Parashikimi i strategjive të të nxënës • Mësimi se si të vlerësohet të nxënës e dikujt • Vlerësimi i efektivitetit të strategjive të të nxënës • Mësimi i strategjive të korrigjimit • Reflektimi mbi progresin e të nxënës Mësuesit t'i mësojnë në mënyrë eksplicite këto aftësi dhe të modelojnë me zë të lartë mendimin dhe qasjet e tyre ndaj detyrave sfiduese të të nxënës.

Aftësitë	Përshkrimi	Aktivitetet
	e të nxënësve dhe motivimin:	

Tabela 10: Shembuj të aftësive që mbështesin nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur

 Shtyllat e gatishmërisë për të mësuar			
Rregullimi i një hapësire studimi	Materiale organizuese	Përcaktimi i një kohe studimi	Organizimi i një rrjeti mbështetës
Një vend i caktuar për të studiuar, i përshtatshëm për qëllimin dhe i rehatshëm (ndenjësë e rehatshme, hapësirë e pastër në tavolinë, akses i lehtë në materialet mësimore, larg nga shpërqendrimet, në një vend të qetë ose me të tjerë përreth kur kjo është ajo që u përshtatet më shumë nxënësve...).	Stilolapsa, lapsa, fletore, tekste shkollore, pajisje IT... Fletore ose dosje të organizuara (ndarëse, kodim me ngjyra...)	Kuptimi se kur, ku dhe sa kohë shpenzohet për të studiuar. Oraret dhe rutinat e mësimi (p.sh. vendosja e së njëjtës orë studimi çdo ditë, ose e njëjta orë e detyrave të shtëpisë çdo ditë).	Kjo mund të përfshijë prindërit, vëllezërit e motrat, të afërmit ose fqinjët, mësuesit, miqtë, bashkëmoshatarët e klasës... Ka të bëjë gjithashtu me mënyrën e kontaktit me rrjetin, sa shpesh dhe sa rregullisht (p.sh. grupi WhatsApp me bashkëmoshatarët, grupi javor i studimit me bashkëmoshatarët, pyetjet për të rriturit, mbështetja e nxënësve për detyrat e shtëpisë, etj.

 Shembuj aktiviteteve për të forcuar vetë-efikasitetin
Afati kohor i arritjeve – Nxënësit përmbledhin çdo vit të jetës së tyre duke përdorur një arritje kyçe për të kuptuar se si ndodh rritja. Kërkojuni nxënësve të projektojnë veten e tyre në të ardhmen dhe të parashikojnë arritjet e tyre në 3 vitet e ardhshme, në 10 vitet e ardhshme, etj... Ky aktivitet më pas mund të çojë në planifikimin e veprimeve, me nxënësit që të shkruajnë 3 veprime që mund të ndërmarrin tani drejt arritjeve të tyre të ardhshme. Kujtimi i përvojave të kaluara – Përpara se nxënësit të angazhohen në një detyrë mësimore komplekse ose sfiduese, kërkojuni atyre të kujtojnë një moment kur kanë arritur një detyrë sfiduese ose komplekse mësimore në të kaluarën. Kërkojuni atyre të kujtojnë se çfarë po

mendonin ndërsa po merreshin me detyrën, si ndiheshin, çfarë po bënin dhe si. Kjo do t'i ndihmojë ata të vendosin veten në një kornizë pozitive të mendimit përpara se të merren me detyrën e re para tyre.

- **Ditari mësimor.** Kërkojuni nxënësve të mbajnë një ditar mësimi në baza ditore ose javore në varësi të moshës dhe interesit. Nxënësit mund të shkruajnë disa fjali në ditar rreth asaj që kanë mësuar, çfarë u duket sfiduese, si i kanë kapërcyer këto sfida, çfarë strategjish mësimore kanë përdorur. Kjo mund të bëhet gjatë orës së mësimi (5 minuta në fund të një ore mësimore) ose në shtëpi. Kërkojuni nxënësve të reflektojnë, çdo muaj ose tremujor, se si kanë përparuar dhe çfarë ka ndryshuar në të nxënësit e tyre në bazë të shënimeve të tyre në ditar.

Burime shtesë për të mësuarit për të mësuar

- Literatura mbi funksionimin ekzekutiv (kujtesa e punës, të menduarit fleksibël dhe vetëkontrolli) – shihni [Harvard University Centre on the Developing Child](#), dhe burime të përshtatshme për moshën [3-5 year-olds](#), [5-7-year-olds](#), [7-12-years-olds](#), dhe [teenagers](#).
- Education Endowment Foundation (2019) [Metacognition and Self-Regulation: Guidance Report](#).
- [Socio-Emotional Learning and School Culture and Climate](#) nga Transforming Education

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin e shkollës suaj me Detyrën 3.

MJETI 11. STRATEGJI PËR MËSIMDHËNIEN DHE TË NXËNIT GJITHËPËRFSHIRËS

Mbështetja e të nxënit për nxënësit në rrezik të braktisjes dhe për ata që mbeten prapa në mësim fillon me përdorimin e parimeve të shëndosha pedagogjike në klasë, si mësimi aktiv, edukimi i diferencuar, Dizajni Universal për të Mësuar dhe strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënit.

Dizajni Universal për të Mësuar

Një parim kyç i arsimit gjithëpërfshirës dhe strategjisë për të trajtuar diversitetin në klasë është përdorimi i Dizajnit Universal për Mësim (DUM), i cili mbështet hartimin e kurrikulave dhe udhëzimeve që janë të arritshme për të gjithë nxënësit në vend që të përpiqen të kujdesen për nevojat e një grupi të caktuar, siç janë nxënësit me aftësi të kufizuara. DUM bazohet në mënyrën se si truri ynë merr, përpunon dhe përgjigjet ndaj informacionit dhe thirrjeve për:

- Mjete të shumta të përfaqësimit të informacionit si fotografi, udhëzime të shkruara dhe gojore, ose materiale të rëndësishme kulturore;
- Mënyra të shumta që nxënësit të demonstrojnë atë që po mësojnë, me gojë, me shkrim, gjeste, manipulim të objekteve etj.; dhe
- Mundësi kuptimplota për të marrë pjesë në mësim, për të siguruar vëmendje, interes dhe motivim. Shembujt përfshijnë optimizimin e zgjedhjes dhe autonominë në aktivitetet e të mësuarit dhe mbështetjen e nxënësve në zhvillimin e aftësive të përballimit dhe vetëvlerësimit (Johnstone, 2014)

Burime për DUM

- <https://www.learningdesigned.org/resources>
- <https://www.cast.org/impact/universal-design-for-learning-udl>

Mësimdhënia gjithëpërfshirëse gjinore dhe të nxënit

Hulumtimet kanë dhënë prova të shumta se si stereotipet gjinore dëmtojnë performancën e djemve dhe vajzave, veçanërisht në lexim (për djemtë) dhe matematikë (për vajzat) (*Pansu et al., 2016; Carlana, 2018, Huguet dhe Regner, 2007*). Ndërsa stereotipet gjinore mund të jenë delikate dhe të brendësuar si nga nxënësit ashtu edhe nga mësuesit, vënia në pyetje e tyre është një pjesë e rëndësishme e rrugëtimit drejt përmirësimit të të nxënit dhe mbështetjes së djemve dhe vajzave në rrezik të braktisjes.

Mësuesit gjithëpërfshirës kanë identifikuar dhe sfiduar paragjykimet e tyre gjinore në mënyrë që të mos ndikohen nga stereotipet pozitive ose negative kur vlerësojnë aftësitë, pikat e forta, dobësitë dhe potencialin e nxënësve. Ata i kushtojnë vëmendje dallimeve të mundshme gjinore në planifikimin e mësimave, krijimin e materialeve, udhëzimet, menaxhimin e klasave dhe vlerësimin e të nxënit.

Thelbi i mësimdhënies gjithëpërfshirëse gjinore është të sigurohet që djemtë dhe vajzat të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga klasa, të mbështeten në përputhje me personalitetin dhe nevojat e tyre dhe të inkurajohen të reflektojnë mbi stereotipet e njëanshme gjinore dhe qëndrimet.

Këshilla për krijimin e mjedisve mësimore gjithëpërfshirëse gjinore

Mësuesit:

- Reflektoni për aftësitë e mësimdhënies, strukturën e klasës, materialet mësimore dhe të të nxënësve, dhe dinamikën e ndërveprimeve në klasë;
- Kërkoni karakteristika/sjellje që rezultojnë nga normat shoqërore që mund të pengojnë mësimin dhe performancën akademike (p.sh. ndrojtja, arroganca, dominimi, bullizmi, mungesa e besimit dhe frika për të folur në klasë);
- Sigurohuni që materialet të përshkruajnë dhe portretizojnë burra dhe gra në role udhëheqëse dhe profesionale;
- Të sigurohet që grupet e punës të jenë të përziera dhe që të gjithë të kenë mundësinë të udhëheqin diskutimet, dhe të paraqesin rezultatet nga puna në grup;
- Sigurohuni që çdo nxënës të ketë mundësi të barabarta për të praktikuar modelet e demonstrimit pa u bërë të ndihet keq dhe pa u nënçmuar nga të tjerët;
- Sigurohuni që djemtë dhe vajzat të ulen si në pjesën e përparme ashtu edhe në pjesën e pasme të klasës;
- Të sigurohet që djemtë dhe vajzat të kenë akses në këndet e klasës, bibliotekën e shkollës, laboratorët dhe kompjuterët;
- Përdorni një gjuhë neutrale gjinore që nuk përforcon paragjykimet ose pabarazitë gjinore;
- Bëni nxënësit më të vetëdijshëm për stereotipet gjinore të lidhura me fushën ku jepni mësim (dhe në profesionet përkatëse);
- Ndihmohuni nxënësit të vënë në dyshim qëndrimet e njëanshme gjinore në mënyrë që të parandalohen që ato të ndodhin në të ardhmen;
- Dekurajimi dhe sanksionimi i sjelljeve diskriminuese dhe seksiste.

Burimet: përshtatur nga USAID (n.d.)

Mësimdhënia gjithëpërfshirëse kulturore dhe të nxënësve

Nxënësit nga pakicat etnike si Romët ose fëmijët refugjatë dhe emigrantë janë ndonjëherë në rrezik të lartë për të braktisur shkollën në rajon.

Miratimi i mësimdhënies gjithëpërfshirëse kulturore dhe të nxënësve jo vetëm që promovon përfshirjen dhe forcon ndjenjën e përkatësisë së nxënësve ndaj shkollës, por është gjithashtu një komponent kyç për ruajtjen e motivimit. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet që të dyja kurrikulat dhe detyrat mësimore janë të rëndësishme për diversitetin e nxënësve dhe bazohen në një sërë përvojash gjuhësore, kulturore dhe jetësore. Mësuesit kanë përdorur strategji të shumta për ta bërë këtë në rajon, që nga vizita në komunitete dhe pjesëmarrja në ngjarje kulturore të komunitetit deri te dhënia e mundësive për nxënësit për të ndarë njohuritë e tyre kulturore dhe për t'u siguruar që referencat kulturore të përfshihen në kurrikulat dhe aspekte të tjera mësimore.

Informacion ndihmës

Produktet teknologjike të cilat janë paraqitur më poshtë janë një mjet shumë i mirë ndihmës, të cilët ju vijnë në ndihmë si mësuesve, ashtu dhe nxënësve për t'u përfshirë sa më shumë në orën e mësimi, për ta bërë atë sa më interesante dhe gjithashtu për të zhvilluar dhe kompetencat digjitale të nxënësve. Të gjitha produktet teknologjike të cilat janë përshkruar më poshtë janë pa pagesë.

Laboratorët virtualë u ofrojnë nxënësve mundësinë të kryejnë në mënyrë aktive punën e tyre laboratorike në një mjedis online.

Simulimet virtuale: Simulimi është një model kompjuterik i sistemeve të vërteta apo teorike të projektuara për të mësuar se si funksionon sistemi.

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/category/earth-science>

<http://www.sciencefairadventure.com/Default.aspx>

<https://www.sciencebuddies.org/science-fair-projects/project-ideas/list>

Web Math—Vendosni një problem dhe shikoni procedurën e zgjidhjes hap pas hapi.
<https://www.webmath.com/index3.html>

Wolfram Alpha—Një motor dije që jo vetëm kryen përlllogaritje të thjeshta dhe komplekse por përmban edhe linke të lidhura me problemet, siç mund të gjenden në një motor kërkimi.
<https://www.wolframalpha.com/>

Filament Games—Me mbështetjen e Institutit e Shkencave Arsimore (ISA) në Departamentin e Edukimit të SHBA-ve, ky grup po zhvillon një sërë lojërash për shkencën e jetës në nivel të shkollës së mesme. Këto lojëra mbështeten në informacione nga praktika arsimore të bazuara në prova dhe në kuadrin e Projektimit Universal për të Nxënësit. Këto materiale kanë për qëllim të përmbushin nevojat e nxënësve me aftësi të veçanta apo aftësi të tjera në lexim.
<https://www.filamentgames.com/projects/>

ExploreLearning Gizmos—Kjo faqe interneti ofron më shumë 400 simulime shumë ndërvepruese të përputhura me standardet për nxënësit e klasës së 3-12. <https://gizmos.explorellearning.com/>

Brainquake—Lojëra telefoni dhe interneti që rrisin ndjeshmërinë e nxënësve me numrat, prirjen për matematikë, gatishmërinë matematikore dhe aftësinë matematikore (në veçanti, hidhini një sy Wuzzit™ Trouble). <https://www.brainquake.com/>

DreamBox Learning—Program zgjidhjes matematikore që përshtatet me nxënësin individual, ofron qasje dhe barazi për Nxënësit e Gjuhës Angleze, si edhe personalizon mësimdhënien në vazhdimësi.
<https://www.dreambox.com/solutions>

Modelet 3-D bëhen të mundura nëpërmjet programeve të sofistikuara që krijojnë kopje tredimensionale të objekteve ose vendndodhjeve. Qendra Kombëtare për Manipulues Virtual në Universitetin Utah State ka një koleksion të këtyre mjeteve për të mbështetur temat e shkencës dhe matematikës. <http://nlvm.usu.edu/>

Tinkercad: Tinkercad është një program pa pagesë për projektim dhe modelim 3-D me ndihmën e kompjuterit (CAD) i cili është i përshtatshëm për arsimtarët dhe ata që e kanë këtë gjë si hobi. Tinkercad lejon përkthimin e projekteve për tu aktualizuar nëpërmjet printimit 3-D. Është një program argëtues dhe mjaft intuitiv për nxënësit që të sjellin në jetë idetë e tyre.
<https://www.tinkercad.com/3d-design>

WISE: Web-based Inquiry Science Environment: TheWise: Web-based Inquiry Science Environment është një platformë arsimore digjitale e cila i lejon nxënësve të vëzhgojnë, analizojnë dhe kryejnë eksperimente në të nxënësit e tyre ndërkohë që punojnë me projektet e tyre WISE. WISE përfshin mjedisin arsimor të nxënësve si dhe shumë mjete të menaxhimit të kursit dhe vlerësimit nga të cilat mësuesit mund të zgjedhin. <https://wise.berkeley.edu/>

Shkencat Shoqërore

Google Expeditions: Një aplikacion i realitetit virtual që lejon nxënësit dhe mësuesit të marrin pjesë në udhëtime virtuale në terren me pamje 360 gradë dhe në 3D nga e gjithë bota.
<https://sites.google.com/tcsnc.org/tcs-g-expeditions/home>

NatGeo Mapmaker Interactive: Një faqe interneti ndërvepruese dhe aplikacion celular që i lejon nxënësit të shtojnë tekste, foto dhe video të personalizuar për të treguar ngjarje për vende të caktuara. <https://mapmaker.nationalgeographic.org/>

Zoom In!: Një platformë pa pagesë dhe e bazuar në rrjet që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e njohurive dhe aftësitë e të menduarit historik nëpërmjet “studimit të thelluar” të burimeve kryesore dhe dytësore. <http://zoomin.edc.org/>

National Archives DocsTeach: Një aplikacion ndërveprues për të punuar me dokumente nga burimet kryesore të Arkivave Kombëtare. <https://www.docsteach.org/documents>

Smithsonian Learning Lab: Një faqe interneti që ju jep mundësi nxënësve të zbulojnë më shumë se 1 milion imazhe digjitale, regjistrime dhe tekste për të krijuar koleksione të personalizuar të aseteve të “Muzeumit Smithsonian”. <https://learninglab.si.edu/>

Chronicling America: Një faqe interneti që ofron një bazë të dhënash, duke siguruar akses në informacione për gazetatat historike amerikane të botuara ndërmjet viteve 1836 dhe 1925. <https://chroniclingamerica.loc.gov/>

Gjuha Angleze

VoiceThread <https://voicethread.com/>

BrainPOP <https://www.brainpop.com/classroom-solutions>

Nevojat e veçanta

Read and Write Gold <https://www.texthelp.com/products/read-and-write-education/>

Read2Go <https://edshelf.com/tool/read2go/>

Livescribe Echo Pen <https://www.ahead.ie/Livescribe>

Inspiration & Kidspiration <https://www.bltt.org/software/inspiration/index.htm>

Dragon Dictation <https://learningworksforkids.com/apps/dragon-dictation/>

Reflektim

1. Duke reflektuar mbi këtë kapitull, çfarë strategjish mund të integroni në klasën/shkollën tuaj për të përmirësuar (i) autonominë e nxënësve dhe të nxënësve pavarur, (ii) motivimin e nxënësve për të mësuar?
2. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të mësimdhënies/shkollës suaj në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënësve gjithëpërfshirës, gjinor dhe kulturor?

MJETI 12. MËSIMDHËNIA PLOTËSUESE

Në këtë seksion ne paraqesim dy opsione kryesore për mbështetjen e të mësuarit: (i) **mësimdhënien plotësuese**, e kuptuar gjerësisht si mbështetje mësimore shtesë e ofruar për nxënësin ose grupet e nxënësve, për t'i ndihmuar ata të arrijnë të nxënitet, veçanërisht në lëndët akademike bazë, dhe (ii) **klasa plotësuese ose shtesë dhe orë studimi**, të cilat mirëpresin nxënësit në baza vullnetare.

Mësimdhënia plotësuese zakonisht synon nxënësit me një kapacitet të shkurtër vëmendjeje, me aftësi të kufizuara në të nxënë, si disleksia, me besim shumë të dobët në aftësinë e tyre për të mësuar, vetëvlerësim të ulët dhe mungesë të fortë motivimi për të mësuar për shkak të mosarritjeve të përsëritura ose arsye të tjera personale.

Mësimdhënia plotësuese bazohet në vlerësimin e plotë të nevojave për të kuptuar se cilat janë çështjet (konjitive, metakonjitive dhe në aspektin e motivimit) dhe objektivat e të nxënitet të vendosura nga mësuesit. Mësimi plotësues mund të marrë disa forma, si p.sh.:

- Mësim individual gjatë orës së mësimit (kur nxënësi tërhiqet nga klasa e rregullt për të ndjekur mësimin ose kur një mësues ndihmës mëson një fëmijë veçmas gjatë orës së mësimit);
- Mësim individual ose mësim në grupe të vogla jashtë orës së mësimit, zakonisht para fillimit të klasës, gjatë pushimit ose pas përfundimit të klasës së fundit.

!	Mësimdhënia plotësuese synon nxënësit që kanë mbetur më shumë prapa, jo t'i ofrohet kohë shtesë mësimore shumicës së klasës.
---	--

Më poshtë janë disa parime për të siguruar mësimdhënie efektive plotësuese:

- Favorizimi i seancave të shkurtra dhe të rregullta (si seanca 30 minutëshe, 3 herë në javë);
- Lidhja e mësimdhënies plotësuese me mësimin e rregullt;
- Baza në objektivat mësimore të identifikuar nga mësuesi i klasës;
- Përfshirja aktive e nxënësve në mësimin e tyre dhe mbështetja e tyre për të kuptuar se çfarë duhet të përmirësojnë dhe pse, edhe përfshirja e tyre në monitorimin e progresit;
- Teknika të ndryshme mësimore dhe materiale mësimore, duke përdorur parimet e Dizajnit Universal për të Mësuarit;
- Diferencimi i materialeve mësimore për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të nxënësve;
- Mësimi i aftësive dhe strategjive të të nxënitet;
- Trajtimi i keqkuptimeve dhe koncepteve të gabuara të të mësuarit;
- Aftësimi i nxënësve që të përparojnë me ritmin e tyre;
- Eksplorimi se si Mësimi i Asistuar nga Kompjuteri mund të mbështesë të mësuarit plotësues. Kjo mund të jetë veçanërisht e vlefshme për arritjen e aftësive themelore të shkrim-leximit dhe numërimit;
- Sigurimi që prindërit të marrin informacionin përkatës për mësimin plotësues;
- Përfshirja e prindërve në rishikimin e progresit të bërë gjatë mësimdhënies plotësuese;
- Monitorimi i progresit.

Opsionet e tjera të mbështetjes mësimore të ofruara nga shkolla mund të përfshijnë klasat shtesë dhe orët e studimit, në mënyrë që nxënësit të bashkohen në një hapësirë të sigurt mësimi të ofruar nga një mësues ose vullnetar shkollë. Këto opsione të mbështetjes mësimore janë zakonisht më fleksibël dhe mund të ndërmerren nga nxënësit në baza vullnetare. Opsione të tilla mund të kenë politika të 'dyerve të hapura', duke u mundësuar nxënësve që të vijnë kur e ndiejnë nevojën. Çështjet për vendin dhe kohën duhet të vendosen bashkërisht me nxënësit, prindërit dhe mësuesit, për të maksimizuar pjesëmarrjen.

Më poshtë janë disa parime për të siguruar mbështetje efektive të të mësuarit shtesë:

- Bazuar në konsultimet dhe nevojat e nxënësve;
- Bazuar në pikat e forta të nxënësve;
- Nxitja e aftësive të studimit, autonomisë dhe të mësuarit të pavarur;
- Nxitja e motivimit për të mësuar;
- Nxitja e të nxënit socio-emocional;
- Metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe materialeve mësimore;
- Përgjigjja ndaj stileve të të nxënit të nxënësve dhe parimeve të Dizajnit Universal të të Mësuarit;
- Nxitja e të nxënit në bashkëpunim;
- Përgëzimi i suksesit të nxënësve;
- Mbledhja e komenteve nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit për të informuar zhvillimin e ardhshëm;
- Vlerësimi i ndikimit në të nxënit, motivimin dhe ndjekjen e shkollës së nxënësve.

!	Pritshmëritë e ulëta të mësuesve për nxënësit e përfshirë në të nxënit plotësues ose në mbështetjen mësimore shtesë janë një çështje kyçe në mbështetjen e të nxënit, si dhe stigmatizimin e nxënësve që ndjekin klasat plotësuese.
---	---

Për të shmangur stigmën që lidhet me mësimdhënien plotësuese dhe opsionet shtesë të mbështetjes së të nxënit, shkollat mund të sigurojnë që e gjithë mbështetja e të mësuarit të bëhet e dukshme dhe e përfshirë në organizimin e saj dhe për këtë arsye përfiton nga:

- Artikulimi dhe promovimi i mbështetjes mësimore si funksion thelbësor i shkollës për të mbështetur suksesin e të gjithë nxënësve;
- Komunikimi i qartë rreth opsioneve të disponueshme për nxënësit dhe prindërit;
- Emërimi i një stafi të shkollës për të mbikëqyrur të gjithë ofrimin e mbështetjes mësimore në shkollë;
- Monitorimi i pjesëmarrjes dhe progresit të nxënësve;
- Mbledhja e komenteve nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit;
- Përfshirja e mbështetjes së të nxënit si fushë e studimit për vetëvlerësimin e shkollës (UNICEF Serbi, 2017).

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin shkollës suaj me Detyrën 3.

MJETI 13. ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË PUNËS DHE SIPËRMARRJES

Në arsimin e mesëm, motivimi i të nxënësve mund të rritet përmes përfundimit të lidhjeve ndërmjet arsimit/programeve dhe mjeteve të jetesës/aksesit në punë, dhe duke e bërë mësimin të përshtatshëm për qëllimet e karrierës së nxënësve.

Kjo mund të bëhet përmes:

- Të ftohen profesionistët të flasën për punën e tyre dhe të diskutojnë rrugën e tyre akademike dhe të trajnimit;
- Të ftohen ish-nxënësit dhe sipërmarrësit e rinj të flasën për përvojën e tyre, zgjedhjet e mëtejshme të arsimimit dhe karrierën e tyre;
- Sesione informimi (të lëndëve të specializuara ose drejtimeve të AFP) për nxënësit, për të vlerësuar interesin dhe motivimin;
- Aktivitete ndër-kurrikulare që fokusohen në sipërmarrjen dhe aftësitë e punësimit (workshop-e për zhvillimin e aftësive të punësimit, klubet e sipërmarrësve etj.);
- Ndërtimi i aftësive për të gjetur një vend pune, punë verore dhe punësim (aftësi për kërkimin e punës, ndërtim CV, letër motivimi, portofol, teknika intervistash, etj.);
- Ndihma e nxënësve për të ndërtuar portofol me eksperiencë profesionale dhe realizime/produkte konkrete.

Të mësuarit sipërmarrës

Të mësuarit sipërmarrës, i quajtur edhe edukimi sipërmarrës, kërkon 'të nxisë vetëvlerësimin dhe besimin duke u mbështetur në talentet dhe kreativitetin e individit, duke ndërtuar aftësitë dhe vlerat përkatëse që do t'i ndihmojnë nxënësit në zgjerimin e perspektivave të tyre për shkollimin dhe mundësitë më tej. Metodologjitë bazohen në përdorimin e aktiviteteve të zhvillimit personal, të sjelljes, motivuese, të qëndrimeve ndaj jetës dhe të planifikimit të karrierës' (UNESCO/ILO, 2006, f.22).

Të mësuarit sipërmarrës është një qëndrim ndaj të mësuarit dhe mësimdhënies që kërkon një ndryshim në kulturën e arsimit. Ai zhvillohet më së miri dhe është më efektiv kur merren parasysh një sërë faktorësh. Këta faktorë janë të ndërlidhur, duke krijuar ekosistemin e të mësuarit sipërmarrës në AFP. Në nivel mikro, çdo institucion dhe mësuesit e tij duhet të hartojnë një përvojë efektive dhe specifike të të mësuarit sipërmarrës.

Niveli mikro. Fusha: Çfarë bëni ju!

- (1) Hartoni përvojë efektive të të nxënësve sipërmarrës: Së pari, keni objektiva të qarta: pse dëshironi të mbështesni të mësuarit sipërmarrës? Cilat rezultate duhet të arrihen për grupin e synuar?
- (2) Kurrikula: Cilat aktivitete kyçe dhe qasje mësimore do të merrni? Çfarë lloj kursesh dhe programesh duhet të zbatohen? Ku duhet të 'jetojë' sipërmarrja në institucionin tuaj?
- (3) Mënyrat e të mësuarit përtej kurrikulës formale: Aktivitetet bashkëkurrikulare, grupet e nxënësve për sipërmarrjen, workshop-et.
- (4) Mbështetje për drejtimet e karrierës dhe bizneset fillestare (start-up): Mentorime dhe mbështetje financiare.

Aktivitetet e mëposhtme ofrojnë një qasje të shkallëzuar për zhvillimin e aftësive, mendësisë dhe kulturës sipërmarrëse. Disa aktivitete do të ndihmojnë në zhvillimin e të mësuarit sipërmarrës në më shumë se një nivel. Kur zgjidhni aktivitete të përshtatshme për nxënësit dhe institucionin, ju mund të gjeni mënyra për të kombinuar një ushtrim të aftësive bazë me atë që ndihmon në ndërtimin e një kulture sipërmarrëse në shkollën dhe komunitetin tuaj.

	Aktiviteti	Përshkrimi	Burimet
1	Dita e Sipërmarrjes me fjalime nga sipërmarrësit	- Hyrja e parë e nxënësve në të mësuarit sipërmarrës. - Bashkëpunimi ndërmjet mësuesve të AFP-së dhe mësuesve të arsimit të përgjithshëm për të krijuar së bashku një ditë frymëzuese të sipërmarrjes.	Qasuni një figure të komunitetit ose industrisë në komunitetin tuaj të bizneseve.
2	Eksplorimi i një kompanie me një kulturë sipërmarrëse	- Informacion në një realitet të ndryshëm pune, i fituar nga angazhimi i nxënësve në detyrat eksploruese. - Nxënësit përgatisin një listë pyetjesh në lidhje me idenë e biznesit, personalitetin sipërmarrës, avantazhin konkurrues, etj.	Kjo kërkon kontakte të mira me kompanitë ose ndërmarrjet në komunitetin tuaj lokal.
3	Sfida e idesë brenda shkollës	Promovimi i gjenerimit të ideve dhe të menduarit për sipërmarrjen, për shembull zhvillimi i modelit të një biznesi.	Të gjithë nxënësit zhvillojnë idenë e tyre të biznesit si projekt në shkollë.
4	Mini-kompani	Mini-kompanitë janë programe ndërgjegjëse që u japin nxënësve mundësinë për të filluar dhe drejtuar një biznes të vogël për një periudhë të caktuar (një ose dy semestra), duke përdorur para deri në një kufi të caktuar qarkullimi.	http://www.juniorachievement.org/
5	Klubi i sipërmarrjes	Klubet e sipërmarrjes ofrojnë një rrugë përmes së cilës nxënësit mund të fitojnë aftësi për të përballuar jetën jashtë shkollës. Klubi përbëhet nga nxënës që janë të apasionuar pas sipërmarrjes.	Klubet e sipërmarrjes janë një aktivitet pas shkollës. Nxënësit takohen me mentorë dhe biznesmenë nga fusha të ndryshme, të cilët mentorojnë dhe nxisin aftësitë e nxënësve.

Burime shtesë

- UNESCO-UNEVOC Të mësuarit sipërmarrës për AFP
<https://unevoc.unesco.org/home/UNEVOC+Publications/lang=en/akt=detail/qs=6437>

MJETI 14. ANGAZHIMI I PRINDËRVE

Mbështetja e prindërve në arsim është një faktor mbrojtës ndaj braktisjes së shkollës. Ajo shoqërohet me rritje të frekuentimit të shkollës, arritje të përmirësuar, rritje të motivimit, nivel më të lartë besimi dhe vetëvlerësimi, përmirësim të ndërveprimit me bashkëmoshatarët dhe shanse më të ulëta për të braktisur shkollën.

“Kush ka të drejtë të zgjedhë shkollimin e fëmijëve”?

Sipas legjislacionit ndërkombëtar, prindërit kanë të drejtë të zgjedhin shkollimin e fëmijëve, por jo të mos i dërgojnë fëmijët në shkollë (fakti i parë i braktisjes). Prindërit kanë të drejtë të shkollojnë fëmijët e tyre në shkolla të përgjithshme ose profesionale.

- Cilat mendoni janë mundësitë e ndërhyrjes në komunitetin e prindërve të shkollës për këto vendime?
- Cilët persona në shkollë mund të trajnojnë edhe procesin e prindërimit, edhe këshilla të kujdesshme për karrierën e fëmijës?

Grupi i trajnimit ndahet në këtë situatë në dy grupe: prindër dhe nxënës.

Diskutoni me prindër (ose si prindër) probleme si:

1. A ka të drejtë fëmija të shprehë mendimin dhe pëlqimin e tij për zgjedhjen e prindërve?
2. Cilët faktorë ndikojnë në këtë proces analize?
3. Për shkollën që ndjek fëmija a jeni i kënaqur?

Diskutoni si nxënës:

1. Ju pëlqen shkolla që po ndiqni?
2. Cila fushë ose drejtim i shkollimit tuaj ju pëlqen më shumë?
3. Do ju pëlqente krahas mësimi, shkolla tu krijonte edhe mundësi punësimi? Cilat janë arsyet e kësaj zgjedhjeje?

Detyrë: Përcaktoni sipas mendimit tuaj me diskutim rolet specifike të situatës dhe mundësitë e arritjes së pritshmërive.

Barrierat për angazhimin e prindërve

Ka një sërë pengesash për angazhimin e prindërve, disa që rrjedhin nga vetë prindërit, të tjera vijnë nga praktikatat e shkollës dhe qëndrimet e stafit të shkollës.

Barrierat nga ana e prindit	Barrierat nga ana e shkollës
Të përgjithshme Shkolla është një mjedis i panjohur ose frikësues Kujtime të pakëndshme nga përvoja personale e shkollës	Mungesa e kohës Nuk ka vend për takime private Mungesa e njohurive në lidhje me angazhimin me prindërit, veçanërisht prindërit 'e vështirë për t'u arritur' ose me prindërit e pafavorizuar

Barrierat nga ana e prindit	Barrierat nga ana e shkollës
Çështjet e transportit (prindërit jetojnë larg); paafhtësi/lëvizshmëri; mungesa e teknologjisë për takime në distancë Orari i takimeve Çështje gjuhësore Mungesa e të kuptuarit të sistemit arsimor apo të pritshmërive të shkollës Normat gjinore (p.sh. arsimimi është çështje e nënave) Frika nga stigmatizimi; frika nga gjykimi (veçanërisht kur nuk ka veshje, këpucë të përshtatshme, etj.) Dallimi midis vlerave/kulturës së shtëpisë dhe shkollës Lodhja në mbledhje ose thirrja në mënyrë të përsëritur për takime për shkak të mungesave së fëmijëve ose problemeve të sjelljes Specifike të të nxënës: Mungesa e kohës Mungesa e kompjuterit/lidhjes dhe aftësive digjitale Aspirata të ulëta për edukimin e fëmijëve të tyre Nivele të ulëta të shkrim-leximit Niveli i ulët arsimor dhe ndjenja se të mësuarit është për 'ekspertët'	Përdorimi i zhargonit arsimor Mungesa e marrëveshjeve për tejkalimin e barrierave gjuhësore Përfshirja e prindërve nuk është pjesë e përkrahimit të punës së mësuesve Mungesa e të kuptuarit se si praktikat kulturore mund të ndikojnë në angazhimin e prindërve me stafin. Supozimet e stafit se prindërit e shkëputur nga shkolla janë prindër të pakujdesshëm Qëndrimet stigmatizuese dhe diskriminuese mes mësuesve/stafit të shkollës Mungesa e trajnimit mes mësuesve dhe stafit të shkollës për angazhimin e prindërve në mësim Mungesa e aktiviteteve që synojnë të mbështesin prindërit që të angazhohen në mësimin e fëmijëve Informacioni i shkollës disponohet vetëm në internet, duke parandaluar aksesin nga prindërit që nuk kanë mundësi

Tabela 11: Barrierat e zakonshme për angazhimin e prindërve

Për shkak se prindërit/kujdestarët janë një grup heterogjen me prejardhje dhe stile të ndryshme angazhimi me stafin e shkollës, shkollat duhet të përshtatin mënyrën se si ata komunikojnë, përfshijnë, angazhohen dhe marrin vendime me prindërit ndonjëherë rast pas rasti. Kur prindërit/kujdestarët janë veçanërisht të cënueshëm, ose kur nxënësit rrezikohen të braktisin shkollën, shkollat duhet të gjejnë strategji shtesë të ndryshme për të punuar në mënyrë efektive me prindërit.

Reflektim

Mendoni për diversitetin e prindërve në shkollën tuaj dhe identifikoni pengesat që ndikojnë tek nënat/baballarët/kujdestarët, veçanërisht nga grupet më të cënueshme apo të marginalizuara për t'u angazhuar me shkollën dhe/ose mësimin e fëmijëve të tyre.

Strategji për angazhimin e prindërve të vështirë për t'u arritur

Për të përmirësuar angazhimin e prindërve, aktivitetet duhet të zhvillohen në dy nivele:

- **Niveli i shkollës:** përmirësimi i komunikimit me prindërit, strategjitë për angazhimin me prindër të vështirë për t'u arritur, rritja e pjesëmarrjes së prindërve në shkolla, rishikimi i asaj që funksionon dhe çfarë jo në angazhimin prindëror;
- **Niveli individual (mësuesi):** strategji për ndërtimin e besimit me prindërit, aftësi dhe teknika komunikimi.

Kur prindërit rrallë angazhohen me shkollën dhe nuk u përgjigjen ftesave për takime ose telefonatave, shkollat duhet të gjejnë strategji të ndryshme për t'i kontaktuar ata. Marrja e perspektivës është e dobishme për të kuptuar pse ata nuk angazhohen dhe si mund të krijohet besimi dhe komunikimi.

Shkollat kanë qenë të suksesshme në vendosjen e kontakteve me prindër të vështirë për t'u arritur përmes:

- Maksimizimi i mundësive për komunikim në distancë (telefon, thirrjet në Zoom, etj.) ose takime në vende të përshtatshme për prindërit, kur është e mundur
- Kryerja e takimeve të rregullta në komunitet për të njohur anëtarët me ndikim të komunitetit dhe për të krijuar besimin ndërmjet shkollës dhe një komuniteti të caktuar;
- Kontakti me ndërmjetësuesit, udhëheqësit e komunitetit, udhëheqësit fetarë, prindër të tjerë ose anëtarë të komuniteteve në përpjekje për të kontaktuar prindërit;
- Kryerja e vizitave në shtëpi;
- Kontakti me shërbimet shëndetësore, sociale dhe autoritetet lokale për të diskutuar strategjitë e mundshme të angazhimit të prindërve ose për të kërkuar mbështetje për të kontaktuar familjen. Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme, si p.sh. që një punonjës social t'i përcjellë familjes informacion pozitiv për performancën e fëmijës së tyre në shkollë ose mesazhe pozitive nga shkolla.
- Zbatimi i strategjive të ndryshme me familje të ndryshme.
- Përkrahja e mësuesve për të zhvilluar marrëdhënie konstruktive me familjet: këshilla për të komunikuar pozitivisht, për të filluar një bisedë, për të përfunduar një bisedë, për të bërë pyetje pozitive dhe mbështetëse, etj.
- Ndryshimi i strategjive kur ato nuk funksionojnë – të bësh të njëjtën gjë sjell të njëjtin rezultat!

Reflektim

Reflektoni se si ju/shkolla juaj angazhohet me prindërit e vështirë për t'u arritur dhe prindërit e nxënësve që rrezikojnë të braktisin shkollën.

1. Si organizohen ndërveprimet?

- kush (drejtorët, psikologët, mësuesit, stafi tjetër mbështetës, apo komunikimi i nisur nga prindërit?);
- (angazhohet) me kë (nënat, baballarët, prindërit e fëmijëve të klasave të caktuara, prindërit e fëmijëve me arritje të ulëta, prindër të nxënësve të paangazhuar, prindër të vështirë për t'u arritur; apo stafi i shkollës?);
- pse (diskutoni një problem frekuentimi ose sjelljeje, jepni informacion, jepni komente pozitive për arritjet, etj.?);
- ku (zyra e drejtorit, klasa, jashtë shkollës, shtëpia e prindërve, online...?);
- si (takime një-për-një, takime në grup, telefonata, letra, e-mail, vizita në shtëpi, takime në komunitet, komunikim formal/joformal, komunikim i rregullt...?).

2. Çfarë vini re në lidhje me modelet kryesore të komunikimit që keni/shkolla juaj ka me prindërit e nxënësve në rrezik braktisjeje?

3. Deri në çfarë mase këto qasje komunikimi adresojnë pengesat e mundshme për angazhimin prindëror të identifikuar në Pjesën 1?

Menaxhimi i bisedave efektive

Shkathtësitë e komunikimit mësues/staf-prind janë kritike për parandalimin e braktisjes. Për të zhvilluar partneritete të forta me prindërit, shkollat duhet të jenë në gjendje të krijojnë, ruajnë dhe ushqejnë komunikimin.

Përgatitja:

Për të qenë të frytshme, bisedat me prindërit duhet të përgatiten, veçanërisht kur trajtohen çështje të frekuentimit të ulët, sjelljes ose arritjeve të ulëta. Elementet kryesore për përgatitjen e bisedës janë:

1. **Pse** po bëni bisedën? (qëllimi i bisedës, çfarë dëshironi të bëjnë prindërit pas bisedës)
2. **Çfarë** duhet të dini dhe çfarë mesazhesh dëshironi të përcillni?
3. **Si** do ta zhvilloni bisedën? (kanalizimi, vendndodhja...)

Fillimi dhe mbyllja e një bisede

Më poshtë janë këshilla për fillimin dhe mbylljen e bisedave të vështira me prindërit.

Fillimi i një bisede:


- Krijoni një atmosferë pozitive;
- Prezantoni veten;
- Shpjegoni kontekstin dhe qëllimin e takimit/bisedës;

Mbyllja e një bisede:

- Përmbledhni atë që është diskutuar;
- Rishikoni çdo vendim të marrë në mënyrë që të gjithë të jenë dakord se kush duhet të bëjë çfarë;
- Shpjegoni se çfarë do të ndodhë pas takimit/diskutimit;
- Jepni detajet e kontaktit të personelit të shkollës që mund të kontaktohet nga familja;
- Përfundoni me pozitivitet;
- Falenderoni familjen për kohën e dhënë.

Kornizë me 4 hapa për bisedat e strukturuar me prindërit:

Përdorimi i kornizës për të drejtuar bisedat tuaja do t'ju ndihmojë të bëni pyetjet e duhura, të mblidhni informacionin që ju nevojitet dhe të merrni përkushtimin që ju nevojitet nga prindërit.



Grafiku 3: Kornizë për drejtimin e bisedave me prindërit

Burimi: Departamenti për Fëmijët, Shkollat dhe Familjet (2009)



Këshilla për dëgjim efektiv

- Përqendrohuni në atë që personi po thotë (fjalët, gjuha e trupit dhe shenja të tjera joverbale)

- Mos ndërprisni – të ndërpresësh do të thotë ‘Ajo që kam për të thënë është më e rëndësishme’ ose ‘Unë jam më i rëndësishëm’ ose ‘Nuk më intereson vërtet se çfarë mendon’. Përkundrazi, përdorni gjeste të vogla ose pohime verbale ‘Kuptoj’ për të treguar se po dëgjoni
- Bëni pyetje sqaruese për t’u siguruar që kuptoni se çfarë thotë personi
- Riformuloni atë që keni dëgjuar që personi të dijë se e keni kuptuar
- ... dhe mbani mend... **nuk mund të dëgjoni nëse vetëm ju flisni!**

Burimi: Schraf (n.d.)

Burime shtesë

- Përfshirja e prindërve-Projekti Përmirësimi i shkollave, i aksesueshëm nga: <http://www.involve-migrants-improve-school.eu/index.php?id=19>
- Fundación Secretariado Gitano Spanjë, Fondi i Arsimit Rom, Fundația Secretariatul Romilor, Ministria e Arsimit e Bullgarisë, Ministria e Arsimit e Rumanisë, Ministria e Arsimit e Spanjës (2013) [Guide for Working with Roma Families towards Achieving the Success of their Children in School](#): Një Propozim Metodologjik Transnacional për Profesionistët.
- Ivanova, V. (n.d.) [Parenting in the prevention of early school leaving in the Roma community. Prevent Project.](#)
- Education Scotland (2017) [Engaging Parents and Families. A toolkit for practitioners.](#)
- Qeveria e Uellsit (2016) [FaCE the challenge together: Family and community engagement toolkit for schools in Wales.](#)
- Mbështetje shkollë-shtëpi (n.d.) [Parental Engagement: A training toolkit for of useful resources for supporting parents with complex needs.](#)

Detyrë

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin shkollës suaj me Detyrën 4.

MJETI 15. PUNA ME AGJENCITË DHE KOMUNITETET E TJERA

Një qasje e tërë e shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës kërkon punë të ngushtë me disa institucione lokale, duke përfshirë: autoritetet e arsimit, autoritetet lokale dhe profesionistët nga shërbime të tjera mund të kenë nevojë të përfshihen, si dhe komunitetet më gjerësisht, nga bizneset tek organizatat e shoqërisë civile.


Partneritetet e komunitetit mund të kontribuojnë me ide, burime njerëzore, aktivitete kurrikulare, jashtëkurrikulare dhe fonde. Ato mund të ndihmojnë në arritjen e komuniteteve tradicionalisht të përjashtuara. Gjithashtu mund të promovojnë shkollën brenda komunitetit dhe ta bëjnë atë të dukshme dhe të forcojnë lidhjet midis arsimit dhe botës së punës.

Shërbimet, agjencitë dhe organizatat e komunitetit

Duke zhvilluar partneritete institucionale dhe komunitare, shkollat mund të shfrytëzojnë ekspertizën, burimet e mbështetjes për aktivitete të tyre të përditshme, duke përfshirë parandalimin e braktisjes së shkollës.

Ekzistojnë tri kategori të gjera aktorësh:

- **Në sistemin arsimor:** shërbime mbështetëse nga Ministria ose departamentet rajonale të arsimit;
- **Shërbimet lokale** publike, private dhe jofitimprurëse për fëmijët dhe familjet;
- **Organizatat e shoqërisë civile** nga sektori kulturor dhe social dhe **bizneset**.



Burimi: Përshtatur prej Columbia University (2016)

Në sistemin arsimor	• Shkollat fillore dhe të mesme • Shkollat profesionale • Institucionet e arsimit të lartë • Ofruesit e mundësisë së dytë të arsimit • Institucionet e formimit të mësuesve • Qendrat burimore • Qendra të edukimit special • Autoritetet arsimore • Psikologë, Këshillues, Ekiye
-----------------------------------	---

Shërbimet lokale (publike & private)	• Autoritetet dhe shërbimet shëndetësore (klinikat, spitalet, qendrat shëndetësore), personeli shëndetësor (mjekët, infermierët, asistentët) • Shërbimet e mbështetjes psikologjike • Autoritetet, shërbimet dhe oficerët e mbrojtjes së fëmijëve • Autoritetet e drejtësisë për të miturit • Autoritetet, oficerët dhe shërbimet policore • Autoritetet, shërbimet dhe oficerët e minoriteteve • Autoritetet, shërbimet dhe oficerët e emigrantëve dhe refugjatëve • Autoritetet rinore dhe punonjësit rinorë • Stafi dhe shërbimet e autoriteteve vendore/bashkisë • Punonjësit socialë dhe shërbimet sociale (për familjen dhe fëmijët) • Stafi dhe shërbimet strehimore (për personat e pastrehë, refugjatët, emigrantët, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, fëmijët e rrugës ose viktimat e dhunës në familje); • Qendrat e punës/agjencitë e papunësisë
Shoqëria civile & bizneset	• OIQ/Organizata Civile me fokus të veçantë arsimor • OIQ/Organizata Civile me fokus më të gjerë të drejtësisë sociale • Shoqatat rinore • Organizatat/shoqatat lokale/komunitare • Bibliotekat • Qendrat kulturore • Shoqatat e pensionistëve • Sektori privat, bizneset lokale • Universitetet • Mediat • Trajnerët e sportit

Tabela 12: Lista e përgjithshme e profesionistëve, shërbimeve, agjencive dhe organizatave të mundshme

Reflektim

1. Me cilat agjenci apo organizata është angazhuar më shumë shkolla juaj për t'i ndihmuar nxënësit të qëndrojnë në shkollë?
2. Me cilat kategori organizatash nuk është angazhuar asnjëherë shkolla juaj për të mbështetur nxënësit për të përfunduar arsimin e tyre?

Angazhimi me agjencitë dhe komunitetet e jashtme

Një aspekt kyç i parandalimit të braktisjes së shkollës në shumë vende dhe komunitete ka qenë të qenit inovativ dhe krijues me partneritetet që shkollat mund të ndërtojnë me organizata të tjera. Këto partneritete mund të synojnë të mbështesin shkollën, nxënësit ose familjet.

Organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset mund të luajnë një rol në parandalimin e braktisjes së shkollës, por ato rrallëherë u kërkohet ta bëjnë këtë nga shkollat të cilat prirën të mos zhvillojnë partneritete me organizata të tjera përveç OJQ-ve.

Më poshtë janë shembuj të kontributeve të mundshme të disa palëve të interesuara.

	Mbështetje për nxënësit dhe familjet	Mbështetje për shkollat
Autoritetet arsimore	- Diskutoni me prindërit/kujdestarët - Diskutoni dhe mentoroni nxënësit - Diskutoni, ndërlidhni dhe planifikoni me drejtorët dhe mësuesit e shkollave - Diskutoni, ndërlidhni dhe planifikoni me komunat/autoritetet lokale - Gjeni vende shkollore - Ndjekja e rasteve specifike (p.sh. përjashtimi...)	- Hartoni dhe vini në dispozicion listat e shërbimeve për familjet dhe fëmijët - Mbështetja e shkollave në planifikimin dhe reagimin për parandalimin e braktisjes së shkollës - Trajnioni shkollat për qasjet e parandalimit të braktisjes, sistemet e paralajmërimit të hershëm, etj. - Ndërtoni rrjete shkollore për të lehtësuar shkëmbimin e ideve dhe shkëmbimin e mësimit dhe praktikave - Diskutoni, ndërlidhni dhe planifikoni me OJQ-të dhe bizneset
Shërbimet sociale	- Kryerja e vizitave në shtëpi - Diskutoni me prindërit/kujdestarët - Diskutoni me fëmijët - Mbështetja e familjeve që aplikojnë për përfitime sociale - Përkrahja e familjeve që të kenë akses në shërbimet e familjes dhe fëmijëve - Menaxhimi i rasteve (punonjësit socialë) - Referimi në shërbime adekuate	Trajnini për shkollat dhe stafin e shkollës për angazhimin e prindërve, legjislacionin dhe çështje të tjera relevante
Bizneset	- Ofrimi i bursave - Mentorimi - Vendet e punës - Ditët e informimit - Ngritja e fondeve për një kauzë (p.sh. teknologjia ndihmëse, tarifat e shkollës së mesme, qendra komunitare, etj.) - Pajisje IT, telefon celular dhe internet	- Ngritja e fondeve për një bibliotekë, libra, një dhomë kompjuteri... - Pajisjet IT - Mirëmbajtja e IT - Kontributi i orientimit në karrierë - Fushata SMS në të gjithë shkollën (për të mbështetur reregjistrimin në shkollë, për të ofruar këshilla mësimore për prindërit, etj.)

Tabela 13: Shembuj të kontributeve për parandalimin e braktisjes së shkollës nga palët e jashtme të interesuara

MJETI 16. TRAJTIMI I MARTESËS SË HERSHME

Martesa e hershme është një shqetësim i veçantë për shumë profesionistë të arsimit në rajon. Martesa e hershme shpesh konsiderohet si një çështje private, e rrënjësuar thellë në praktikat e komunitetit dhe kulturës. Mësuesit dhe profesionistët nga sektorë të tjerë shpesh nuk ndihen të përgatitur për të adresuar këtë çështje. Megjithatë, martesa e hershme shpesh bie ndesh me mirëqenien e përgjithshme të adoleshentëve.

Arsyet pas martesës së hershme ndryshojnë nga komuniteti në komunitet. Faktorët e zakonshëm përfshijnë, disa prej të cilëve janë përkeqësuar nga pandemia:

- Perceptimi i mungesës së mundësive;
- Shqetësimet e sigurisë (për vajzat);
- Reduktimi i varfërisë – prindërit mendojnë se martesa do t'u japë vajzave të tyre përfitime më të mira sociale, financiare dhe materiale;
- Normat gjinore, si imazhi i nënave në komunitet, çështjet e nderit dhe turpit, normat që kufizojnë lidhjet, vajzat që perceptohen si mall/aset, normat rreth seksit paramartesor dhe vlerës së virgjërisë, dhe stigma dhe diskriminimi i vajzave të pamartuara;
- Normat më të gjera shoqërore si identiteti etnik, roli i martesës në konsolidimin e komunitetit dhe injoranca për shëndetin ose pasojat ligjore të martesës së hershme (UNICEF, 2018b).

Përgjigjja ndaj çështjeve të martesës së hershme në mënyrë holistike kërkon aktivitete të koordinuara shumë-sektoriale para, gjatë dhe pas martesës së hershme.

Trajtimi i martesës së hershme	Shkollat	Autoritetet & shërbimet lokale	Shoqëria civile
Zhvillimi i aftësive (komunikimi, negocimi, përcaktimi i qëllimeve etj. përmes kurrikulës, jashtë-kurrikulës dhe aktiviteteve të bashkëmoshatarëve) që vajzat mund të aplikojnë për të negociuar ruajtjen e arsimit dhe vonimin e martesës	✓		✓
Rritja e ndërgjegjësimit për efektet negative të martesës së fëmijëve (përfshirë prindërit romë në komunitetet ku praktikohet martesa e hershme), duke përfshirë aktivitetet bashkëmoshatare.	✓	✓	✓
Pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit (veçanërisht vajzat dhe vajzat romë në kontekste me norma të larta të prevalencës së martesave të hershme në një komunitet rom)	✓		
Lidhja me modele të grave (organizata ose individë)	✓		✓
Takime me prindër dhe drejtues të komunitetit, punë me ndërmjetës	✓	✓	✓
Ofrimi i mundësive për djemtë dhe vajzat që të eksplorojnë normat dhe stereotipet sociale dhe gjinore për të inkurajuar ndryshime në qëndrime dhe sjellje	✓		✓
Aktivitetet e shëndetit seksual dhe riprodhues (kurrikula, aktivitetet e bashkëmoshatarëve, aktivitetet jashtëshkollore)	✓		✓
Angazhimi i djemve që të bëhen agjentë të ndryshimit dhe në përkrahjen e martesës së vonë, në mënyrë që djemtë dhe vajzat	✓		✓

Trajtimi i martesës së hershme	Shkollat	Autoritetet & shërbimet lokale	Shoqëria civile
të mund të përfundojnë arsimin e tyre, duke përfshirë arsimin e mesëm të lartë, përpara martesës.			
Ndërhyrjet e përgjithshme për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe mbështetje për tranzicionin	✓	✓	✓
<i>Nëse vajza është e martuar:</i>			
Program i individualizuar i punës për të mbështetur kthimin në arsim	✓		
Negocimi i orëve fleksibël të shkollës	✓		
Takimi me bashkëshortin/vjehrrën Lidhja me modele të grave, OJQ-të dhe shërbimet lokale		✓	✓

Tabela 14: Trajtimi i martesës së hershme: aktivitete të koordinuara para, gjatë dhe pas martesës së hershme

Reflektim

Si po kontribuon shkolla juaj në parandalimin e martesave të hershme? Si po i mbështet shkolla juaj vajzat shtatzëna dhe nënat adoleshente për të vazhduar studimet e tyre?

DETYRA 1. TRANZICIONET ARSIMORE

Krijoni një model me tre nivele (shih seksionin X për informacion të një modeli me tre nivele) për të mbështetur (ri)angazhimin e nxënësve dhe kalimin në ciklin e ardhshëm arsimor në klasën/shkollën tuaj.

Hapi 1: Hartoni një strategji tranzicioni arsimor.

1. Si i përkrahni aktualisht grupet e reja të nxënësve në shkollën tuaj?
2. *(Për shkollat me nivele të mesme të ulëta)* Si i përgatisni grupet e nxënësve që do të kalojnë në nivelin tjetër të arsimit në shkollën tuaj (p.sh. nxënës që janë gati të kalojnë në shkollën e mesme të lartë)?
3. Duke përdorur pesë fushat për ndërhyrje mbështetëse të tranzicionit arsimor (administrative, sociale dhe personale, pedagogjike dhe kurrikulare, të mësuarit dhe ofrimit të mbështetjes):
 - a. Në çfarë është shkolla juaj e mirë? Si e dini?
 - b. Çfarë mund të përmirësojë shkolla juaj? Si?
4. Rendisni ndërmjet 3 deri në 5 ndërhyrje të synuara që mund të prezantoni në klasën/shkollën tuaj për të mbështetur tranzicionin arsimor të nxënësve më të rrezikuar nga braktisja?

DETYRA 2. MIRËQENIA E NXËNËSIT

Hapi 1: Hartoni strukturat (ekipet/stafin mbështetës të mirëqenies) dhe aktivitetet në shkollën tuaj për të mbështetur mirëqenien e nxënësve. Ju mund t'i hartoni këto në pesë fushat e listuara në Mjetin X më lart: (i) Udhëheqja, (ii) Etosi, (iii) Pjesëmarrja e Nxënësve, (iv) Partneriteti dhe (v) Aktivitetet Mbështetëse. Përgjigju pyetjeve në vazhdim:

1. Cilat janë pikat kryesore të forta të shkollës suaj në mbështetjen e mirëqenies socio-emocionale të nxënësve?
2. Cilat janë boshllëqet në mbështetjen e mirëqenies socio-emocionale të nxënësve?
3. Cilat janë fushat kryesore për përmirësim në shkollën tuaj në lidhje me mbështetjen e mirëqenies socio-emocionale të nxënësve?
4. Cilat janë tre fushat kryesore për përmirësim që duhet të adresohen në shkollën tuaj?

Bëni rishikimin tuaj sa më gjithëpërfshirës që të jetë e mundur

Hapi 2: Duke reflektuar mbi hartimin dhe vlerësimin e hapit 1, krijoni ose rishikoni qasjen tuaj të gjithë shkollës për mirëqenien e nxënësve, veçanërisht për ata që rrezikojnë ta braktisin shkollën, duke përdorur pyetjet e mëposhtme si udhëzim.

1. Identifikoni atë që ju/shkolla juaj duhet (i) të ndalojë së bëri, (ii) të bëjë më shumë (iii) të bëjë më pak (iv) të fillojë të bëjë.
2. Zhvilloni një model me tre nivele për ndërhyrjet në mirëqenien e nxënësve tuaj. Sigurohuni që po hartoni ndërhyrje veçanërisht për nxënësit në rrezik të braktisjes. Sigurohuni që ndërhyrjet tuaja të jenë ambicioze, por realiste. Rishikoni përmbajtjen dhe këshillat nga ky modul për t'u siguruar që qasja juaj është holistike.
3. A keni përfshirë strategjitë e mbështetjes së bashkëmoshatarëve në modelin tuaj? Nëse jo, si mund të shtoni mbështetjen e tyre për të kontribuar në parandalimin e braktisjes?
4. Identifikoni përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme për të zbatuar modelin tuaj me tre nivele.
5. Identifikoni se kush mund t'ju ndihmojë të zbatoni ndërhyrjet tuaja (burimet njerëzore dhe financimi).
6. Si do ta monitoroni qasjen tuaj për mirëqenien në të gjithë shkollën?

DETYRA 3. MBËSHTETJA PËR TË MËSUARIT

Përmirësimi i mbështetjes së të mësuarit për nxënësit në rrezik të braktisjes.

Hapi 1: Rishikoni gjendjen ekzistuese të mbështetjes mësimore

1. Në çfarë mase shkolla juaj adreson të mësuarit socio-emocional? Cilat janë fushat kryesore për përmirësim në lidhje me të mësuarit socio-emocional në shkollën tuaj nga të cilat mund të përfitojnë të gjithë nxënësit?
2. Cila është dispozita e shkollës për mbështetjen e të nxënësve për nxënësit në rrezik të braktisjes dhe me mosarritje? A u shërben mbështetja juaj të gjithë nxënësve në rrezik të braktisjes, në të gjitha moshat dhe klasat?
3. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të ofrimit të mbështetjes suaj të të nxënësve për nxënësit në rrezik të braktisjes?
4. Cilat fusha të strategjive tuaja ekzistuese të mbështetjes së të nxënësve duhet të përmirësohen?

Bëni rishikimin tuaj sa më gjithëpërfshirës që të jetë e mundur.

Hapi 2: Duke reflektuar mbi hartimin dhe vlerësimin e Hapit 1, si mund të përmirësojë shkolla juaj mbështetjen e të mësuarit për nxënësit që janë më të rrezikuar?

1. Në cilat ndërhyrje të targetuara mund të fokusohet shkolla juaj për t'iu përgjigjur nevojave të të nxënësve të nxënësve? (mund të përdorni informacionin nga Mjetet X Y Z si bazë)
2. Si duhet të zbatohen këto ndërhyrje (nëse janë të reja) apo të përmirësohen (nëse janë në vazhdim) për të qenë efektive?
3. Si mund t'i përfshini nxënësit dhe prindërit në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ofrimit të mbështetjes mësimore?
4. Si do ta monitoroni progresin dhe do të vlerësoni efektivitetin e ndërhyrjeve tuaja në mbështetje të të nxënësve?
5. Çfarë mbështetje keni nevojë dhe nga kush për të zbatuar ofrimin e mbështetjes për të mësuar?

DETYRA 4. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE

Zhvilloni një plan për të përmirësuar angazhimin e prindërve në shkollën/klasën tuaj.

Hapi 1: Kryeni vetë-vlerësimin e angazhimit të prindërve të paraqitur në kapitullin 6. Për secilën pyetje zgjidhni p

ërgjigjen që përputhet më mirë me situatën e shkollës suaj. Jini sa më të sinqertë dhe shtoni komente për të justifikuar pikët tuaja sa herë që është e nevojshme.

Hapi 2: Bazuar në vetë-vlerësimin, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Cilat janë pikat kryesore të forta të shkollës suaj në angazhimin e prindërve?
2. Cilat janë dobësitë kryesore të shkollës suaj në angazhimin e prindërve?
3. Zgjidhni tre fusha prioritare të praktikës në angazhimin prindëror që kërkojnë përmirësim.
4. Nxirrni ide veprimesh që ju/shkolla juaj mund të ndërmarrë në këto tre fusha prioritare.
5. Cili është hapi i parë që duhet të ndërmarrë shkolla juaj për të bërë ndonjë ndryshim në këto fusha?

Hapi 3: Zhvilloni një plan të thjeshtë për të përmirësuar angazhimin e prindërve në shkollën/klasën tuaj. Plani duhet të përfshijë si ndërhyrje universale ashtu edhe ndërhyrje të synuara për prindërit e vështirë për t'u arritur dhe prindërit e nxënësve që rrezikojnë të braktisin shkollën.

DETYRA 5. PUNA ME SHËRBIMET LOKALE DHE KOMUNITETET

Forcimi i partneriteteve me shërbimet lokale dhe organizatat e komunitetit.

Hapi 1: Kryeni një vlerësim të shpejtë të efektivitetit të shkollës suaj në punën me shumë agjenci, duke përdorur shabllonin në Kapitullin 6 më sipër.

1. Vlerësoni çdo artikull në një shkallë nga 0-4.
2. Reflektoni për: (i) çfarë po bëni mirë, (ii) çfarë mund të bëni më mirë dhe (iii) çfarë mund të bëni më shumë.

Hapi 2: Kryeni një vetë-vlerësim të shpejtë të partneritetit të shkollës suaj me komunitetin duke përdorur shabllonin e Kapitullit 6 më sipër.

3. Vlerësoni çdo artikull në një shkallë 0-4.
4. Reflektoni për: (i) çfarë po bëni mirë, (ii) çfarë mund të bëni më mirë dhe (iii) çfarë mund të bëni më shumë.

Hapi 3: Me informacionin nga Hapi 1 dhe Hapi 2, stuhi mendimesh:

1. Strategjitë për të rritur pjesëmarrjen e agjencive dhe shërbimeve të qeverisjes shtetërore dhe vendore në parandalimin e braktisjes së shkollës, për të mbështetur kthimin e fëmijëve në shkollë, mësimin dhe mirëqenien.
2. Strategjitë për përmirësimin e partneriteteve me aktorët e komunitetit, veçanërisht OJQ-të, bizneset, universitetet, organizatat e shoqërisë civile, organizatat lokale dhe për t'i përmirësuar ato më shumë në aktivitetet e parandalimit të braktisjes së shkollës, për të mbështetur kthimin e fëmijëve në shkollë, mësimin dhe mirëqenien.
3. Identifikoni disa organizata me të cilat nuk jeni angazhuar kurrë dhe krijoni strategji idesh për t'i përfshirë ato në aktivitetet e parandalimit të braktisjes së shkollës, për të mbështetur kthimin e fëmijëve në shkollë, mësimin dhe mirëqenien.

Hapi 4: Zhvilloni një plan të thjeshtë se si shkolla juaj do të rrisë dhe forcojë partneritetin duke punuar për parandalimin e braktisjes së shkollës, duke përfshirë gjatë gjithë pandemisë për të mbështetur fëmijët.

Aneks 2. Burime Shtesë

Publikimet kryesore të Bashkimit Evropian për braktisjen e hershme të shkollës:

- Komisioni Evropian (2010) [Commission Staff Working Paper Reducing early school leaving. Accompanying document to the Proposal for a Council Recommendation on policies to reduce early school leaving](#), Bruksel: Komisioni Evropian.
- Komisioni Evropian (2011) Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve. [Tackling early school leaving: A key contribution to the Europe 2020 Agenda](#), Bruksel: Komisioni Evropian..
- Grupi Tematik i Punës i Komisionit Evropian për braktisjen e hershme të shkollës (2013) [Reducing early school leaving: Key messages and policy support. Final Report of the Thematic Working Group on Early School Leaving](#). Nëntor 2013, Bruksel: Komisioni Evropian.
- Komisioni Evropian (2015) A [whole school approach to tackling early school leaving: Policy messages](#). Arsimit & Trajnim 2020, Politika e Shkollave: Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit dhe Kulturës.

Për më shumë informacion, shihni: http://ec.europa.eu/education/policies/european-policy-cooperation/et2020-framework_en

Burime të tjera të dobishme për parandalimin e braktisjes:

- School Education Gateway <https://www.schooleducationgateway.eu/en/pub/index.htm>
- Byroja e Malit të Zi për Shërbime Arsimore (2013) [Manual for professionals \(teachers, professional associates, principals, Roma and Egyptian assistants\) and all those who are interested in prevention of dropping out of schools in Montenegro](#). Podgorica: Ministria e Arsimit.
- Jovanović et al. (2016) [How to be a caring school? A study on the Effects of Prevention and Intervention Measures for Preventing the Dropout of Students from the Education System of the Republic of Serbia](#), Beograd: UNICEF, Qendra për Politika Arsimore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik.
- Departamenti i Arsimit i Nova Scotia (2005) [Transition Planning for Students with Special Needs](#). Vitet e hershme deri në jetën e të rriturve.
- Victoria State Government (n.d.) [Transition Planning](#) [Online].
- Young Minds UK, [Transition Tips for Students with SEN](#)

Burime specifike për AFP

- Paketa e mjeteve CEDEFOP për AFP-në për lënien e hershme të shkollës <https://www.cedefop.europa.eu/en/tools/vet-toolkit-tackling-early-leaving>
- CEDEFOP Largimi i hershëm nga AFP <https://www.cedefop.europa.eu/en/country-reports/early-leaving-from-vet>
- UNESCO-UNEVOC AFP për të rinjtë e pafavorizuar <https://unevoc.unesco.org/home/UNEVOC+Publications/lang=en/akt=detail/qs=6492>
- UNESCO-UNEVOC Mësimi sipërmarrës për AFP <https://unevoc.unesco.org/home/UNEVOC+Publications/lang=en/akt=detail/qs=6437>
- Largimi i hershëm nga AFP - Qipro <https://www.cedefop.europa.eu/en/country-reports/early-leaving-vet-cyprus>

Aneks 3. Bibliografia

Appleton, J., Christenson, S., Furlong, M. (2008) Student Engagement with School : Critical Conceptual and Methodological Issues of the Construct, in Psychology in the Schools, Vol. 45(5), 2008 Wiley Periodicals Inc.

Attendance Works <https://www.attendanceworks.org/chronic-absence/addressing-chronic-absence/monitoring-attendance-in-distance-learning/>

Australian Institute of Health and Welfare (2012) Social and emotional wellbeing: development of a Children's Headline Indicator. Cat. No.PHE 158. Canberra: AIHW.

Bélair, F (2009) Ma Classe-Qualité au secondaire. Des outils pratiques de gestion de classe inspirés par la Théorie du Choix. Les éditions de la Chenelière Inc

Borgna, C., Struffolino, E., (2017) Pushed or pulled? Girls and boys facing early school leaving risk in Italy, in Social Science Research, Volume 61, January 2017, Pages 298-313

California Department of Education (2018) Social-Emotional Development Domain. Last Accessed 23/12/2018 from <https://www.cde.ca.gov/sp/cd/re/itf09socemoddev.asp>

Columbia University (2016) Collective Impact and The New Generation Of Cross-sector Collaborations For Education

Council for the Curriculum Examinations and Assessment of Northern Ireland (2014) Identifying and Supporting Learners with Social, Emotional and Behavioural Difficulties

Department for Children, Schools and Families (2009) Achievement for All: the Structured Conversation. Handbook to support training, London: Department for Children, Schools and Families.

Department of Education Northern Ireland (n.d.) Pupils' emotional health and wellbeing. Accessed on 06/01/2019 from <https://www.education-ni.gov.uk/articles/pupils-emotional-health-and-wellbeing>

Department of Education of South Australia (2013) Guidance in responding to children and young people. Last accessed on 18/03/2019 from <https://www.education.sa.gov.au/doc/guidance-responding-children-and-young-people>

Education Council (2018) Australian Student Wellbeing Framework. Last Accessed 27/12/2018 from https://www.studentwellbeinghub.edu.au/docs/default-source/aswf_booklet-pdf.pdf

Education Endowment Foundation (2018) [Teaching and Learning Toolkit](#).

Education Endowment Foundation (2018b) [Peer-tutoring](#) [Online].

EEF (2020) [Improving Social and Emotional Learning In Primary Schools. Guidance Report](#).

Eire Department of Education (2021), [Supporting the Wellbeing of School Communities as Schools Reopen: Guidance for Schools](#). Dublin: Eire Department of Education

Finn, J. D. (1993) School engagement and students at risk. Washington, DC. National Center for Education Statistics.

Foresight. (2008). Foresight Mental Capital and Wellbeing Project: Final Project Report. London: The Government Office for Science. Retrieved from: <http://www.bis.gov.uk/foresight/our-work/projects/current-projects/mental-capital-and-wellbeing>

Great Schools Partnership (n.d.) [The Glossary of Education Reform](#).

Harrington, I. (2005) The use of school discourses to understand boys early school leaving in Queensland, Australia. Paper presented at British Educational Research Association Annual Conference, University of Glamorgan, 14-17 September 2005.

Her Majesty Inspectorate of Education (2006) How Good Is Your School. Self-Evaluation Series. Partnership with parents.

Involve parents-Improve schools project (n.d.) [Online] Last Accessed 12/12/2018 from: <http://www.involve-migrants-improve-school.eu/>

Lavrentsova, E., Valkov, P. (2017) Dropping Out Of School: Risk and Protective Factors, ABOR et EDUCATIO nr 5/2017, DOI: 10.4467/25439561LE.17.006.7981

Lehr, C.A., Johnson, D.R., Bremer, C.D., Cosio, A., Thompson, M. (2004) Essential tools: Increasing Rates of School Completion: Moving From Policy and Research to Practice A Manual for Policymakers, Administrators, and Educators, Minneapolis: National Center on Secondary Education and Transition.

Lyche, C. S. (2010) Taking on the Completion Challenge. A Literature Review on Policies to Prevent Dropout and Early School Leaving. OECD Education Working Papers, No. 53, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/5km4m2t59cmr-en>

McLaughlin, C. (ed.) (2015) The Connected School: A Design for Well-Being – Supporting Children and Young People in Schools to Flourish, Thrive and Achieve, London: Pearson

McLeod, S. (updated 2018) [Maslow's Hierarchy of Needs](#). Simply Psychology [Online].

McMurtry, D. (2005) Understanding School Ethos. Presentation at the 'How Good is Our Ethos?' Conference, 7 June 2005.

Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo and UNICEF (2014) [Equity in Education for All: Manual for School Prevention and Response Teams Towards Abandonment and Non-Registration in Compulsory Education](#).

OECD (2017) PISA 2015 Results (Volume III) Students' Wellbeing.

Rumberger, R. (1995) Dropping out of Middle School: A Multilevel Analysis of Students and Schools. American Educational Research Journal, Vol. 32, No. 3 (Autumn, 1995), pp. 583-625

Schraf, A. (n.d.) Critical Practices for Anti-bias Education, Montgomery: Teaching Tolerance.

Scottish Government (2008) Building positive relationship. A training programme for support staff.

Starr (2011) The Coaching Manual. Third Edition. Pearsons Education Limited.

Trickey, S., Coldwell, M., Holland, M., Close, P., Rybinski, D. (2005) Evaluation of Valued Youth: A National Peer-Tutoring Programme To Increase Self Confidence And Motivation. Paper presented to the European Conference on Educational Research, University College Dublin, 7-10 Sep 2005

UK Department of Education (2017) [Preventing and tackling bullying Advice for headteachers, staff and governing bodies](#)

UNESCO and UN Women (2016) Global Guidance on addressing school-related gender-based violence. Paris: UNESCO

UNICEF (2011) The Right of Roma Children to Education: Position Paper. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS).

UNICEF (2012) The Right of Children with Disabilities to Education: A Rights-Based Approach to Inclusive Education. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS).

UNICEF (2015a) A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities. UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS).

UNICEF (2015b) Training of Trainers Modules on Inclusive Education. Available from <https://www.unicef.org/eca/education>

UNICEF (2015c) The Investment Case for Education and Equity, New York: UNICEF.

UNICEF (2017) Improving Education Participation. Policy and Practice Pointers for Enrolling All Children and Adolescents in School and Preventing Dropout. UNICEF Series on Education Participation and Dropout Prevention, Volume 2. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States.

UNICEF (2018) Early Warning Systems for Students at Risk of Dropping Out. Improving Education Participation. Policy and Practice Pointers for Enrolling All Children and Adolescents in School and Preventing Dropout. Geneva: UNICEF Regional Office for Europe and Central Asia.

UNICEF (2018b) Child Marriage in Europe and Central Asia. UNICEF's Response: Regional Overview. Geneva: UNICEF ECARO.

UNICEF and Holt IS (2015) Ca este educația parentală? Last accessed on 10/12/2018 from: http://www.unicef.ro/wp-content/uploads/Ce-este-educatia-parentala_2015.pdf

UNICEF and Ministry of Education of Bulgaria (2018) Guidelines for School Enrolment Teams.

UNICEF and UIS (2016) Monitoring Education Participation: Framework for Monitoring Children and Adolescents who are Out of School or at Risk of Dropping Out. UNICEF Series on Education Participation and Dropout Prevention, Vol I. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States.

UNICEF Se

UNICEF Serbia (2017) Kako do kvalitetne dopunske nastave –oslonci za unapređenje i primeri dobre prakse.

USAID (n.d.) [Introduction to gender responsive teaching methods](#).

Welsh Government (2015) Family and community engagement toolkit. Accessible at <https://learning.gov.wales/docs/learningwales/publications/160712-face-toolkit-main-en.pdf>

WHO (2011a) [Evidence for gender responsive actions to promote well-being Young people's health as a whole-of-society response](#). WHO Regional Office for Europe.

WHO (2011b) [Evidence for gender responsive actions to promote mental health Young people's health as a whole-of-society response](#). WHO Regional Office for Europe.